

RAPORT VJETOR 2020





Realizuar nga Administrata e U.P.
Nën kujdesin e Presidentes Znj.Valbona Treska

RAPORT VJETOR 2020

© URDHRI I PSIKOLOGUT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Tabela e lëndës

	Fq.
Përshëndetja e Presidentit.....	4
1. Rrugëtimi i institucionit gjatë vitit 2020.....	7
2. Organet e Urdhrit të Psikologut dhe aktiviteti i tyre funksional.....	31
2.1 Asambleja Kombëtare.....	32
2.2 Këshilli Kombëtar.....	33
2.3 Komisioni i Gjyqimit Disiplinor Profesional.....	35
2.4 Komisioni i Edukimit në Vazhdim në Psikologji.....	37
2.5 Administrata e Urdhrit të Psikologut.....	40
2.6 Komisione të tjera.....	41
2.6.1 Komisioni i Licencimit.....	41
2.6.2 Komisioni i Praktikës Profesionale.....	41
2.6.3 Komisioni i Vlerësimit të Aftësimit Praktik.....	42
2.7 Koordinatorët Lokalë.....	43
3. Anëtarësia e Urdhrit të Psikologut.....	45
3.1 Psikologë të licencuar.....	45
4. Ndërtimi i regjistrimit elektronik online.....	47
5. Rruga drejt provimit të parë të shtetit për profesionin e psikologut.....	48
6. Rrjetet Sociale të Urdhrit të Psikologut.....	50
7. Buxheti.....	51
7.1 Te ardhurat.....	51
7.2 Shpenzimet.....	52
8. Objektivat e realizuar gjatë vitit 2020.....	54
9. Objektivat për vitin 2020.....	55



PËRSHËNDETJA E PRESIDENTES



*Dr. Valbona Treska
Presidente*

Të nderuar miq dhe kolegë,

Kur u ula të shkruaj këtë fjalë përshëndetëse, mendova se nuk do të kishim shumë gjëra për të paraqitur për vitin 2020, që sapo pasoi. Pandemia Covid-19 na ndryshoi të gjithëve objektivat dhe planet tona personale dhe padyshim, Urdhri i Psikologut nuk mund të mbeste pa u prekur nga kjo furtunë, që ende e kemi mes nesh.

Mendova se nuk do të kemi shumë për të thënë pasi planet tona thelbësore të këtij viti, siç ishte anëtarësimi në IUPsyS, apo pjesëmarrja fizikisht në Kongresin e Psikologëve Amerikanë, nuk mundën të realizoheshin. Bashkë me to shumë punë të përditëshme të U.P., takimet me anëtarësinë, tryezat e rrumbullakta me institucionet, apo trajnimet dhe workshop-et,

u pezulluan dhe ishte e pamundur të funksiononim si në një vit të zakonshëm.

2020-ta ishte një vit i jashtëzakonshëm! Nëse në fundin e 2019-ës përjetuam tërmetin e fortë, i cili na ndikoi të gjithëve dhe aktivizoi maksimalisht institucionin tonë, 2020-ta nuk ishte më një ngjarje veç e jona. Ishte e të gjithë botës! Pandemia na ndryshoi plotësisht të gjithë mënyrën e komunikimit, por siç solli me vete trishtim dhe pasiguri, po aq solli edhe gjëra të bukura, kontakte shumë më të intensifikuara, mbështetje reciproke dhe unitet të trupës së psikologëve në mbarë botën.

Ky vit ka qenë në të vërtetë Viti i Psikologëve. Asnjëherë më parë ndihma dhe asistenca jonë nuk ishte kërkuar në rang global në të njëjtën kohë. Ishte viti ynë, sepse çdokush, që nga Kanada, Islanda, Kenia, Kina, Kongo, Gjermania, India, Anglia dhe kudo në botë, i dha rëndësi profesionit të psikologut gjatë këtyre muajve. Asnjëherë më parë mbledhjet online nuk kanë qenë kaq të shpeshta dhe kaq masive. Të gjithë organizatat e psikologëve kanë bërë një punë të jashtëzakonshme me materialet që kanë shpërndarë në ndihmë të popullatës, me deklaratat që kanë bërë, protokollet e punës që u ndërtuan specifikisht për situatën Covid-19 dhe me daljet dhe prononcimet publike të vazhdueshme. Jo vetëm për këtë frymë të madhe bashkëpunimi që na bashkoi globalisht, por edhe për rezultatet që patëm në nivel kombëtar dhe arritjet e këtij viti, më bëjnë të besoj se ky, ISHTE VITI I PSIKOLOGËVE!

Sa më shumë i kthehem veprimtarive të këtij viti, takimeve online, punës nga shtëpia gjatë marsit dhe vështirësisë për të



qenë ballë për ballë, aq më shumë e kuptoj, se çfarë gjërash të jashtëzakonshme kemi bërë gjatë këtij viti të gjithë bashkë.

Ky ka qenë viti i firmosjes së Memorandumit të Bashkëpunimit me Shoqatën e Psikologëve Amerikanë (APA). Kjo ëndërr e hershme e çdo psikologu në çdo cep të Shqipërisë, është bërë e mundur në datë 28.07.2020. Në aspektin profesional, personalisht nuk mund të festoja më bukur ditëlindjen time të 40-të, se sa me firmosjen e këtij Memorandumi.

Ky ka qenë viti i të qenurit prezentë në disa prej gazetave më prestigjioze në botë si New York Times, Reuters si dhe në disa prej mediave vizive botërore me shikueshmëri të lartë, për Deklaratën e bërë në cilësinë e Presidentes së Urdhrit mbi “Ndalimin e Terapisë së Konvertimit për Komunitetin LGBTIQ”. Kjo Deklaratë bëri menjëherë xhiron e botës dhe Shqipëria u cilësua si vendi i tretë në Europë, që ndalonte Terapinë e Konvertimit, pas Maltës dhe Zvicrës.

Por kjo nuk ka qenë e vetmja arritje në nivelin e mediave ndërkombëtare. Pandemia Covid-19 evidentoi edhe një herë shpirtin e skuadrës së psikologëve shqiptarë, për t’u bërë bashkë në ditë të vështira.

Marsi 2020 nuk do të fshihet lehtë nga memorija e çdo qytetari. Bota mbarë mbajti frymën dhe u karantinua për shkak të pandemisë. Ndaloi New York, Londra, Roma, por dhe Tirana e mbarë Shqipëria. Nën ndjesi të mëdha frike dhe pasigurie, të gjitha institucionet në vend dhe thuajse të gjitha bizneset, ndaluan së punuari. Të zinte paniku nga qetësia absolute e një kryeqyteti, që nuk ndalon kurrë as natën. Dëshiroja shumë, që në ato ditë ku intensiteti i ngarkesës emocionale dhe ankthit ishte mjaft i lartë, të vinim sa më shumë në

ndihmë të popullatës. Dalja në media nëpërmjet lidhjeve *Skyp* me studiot televizive, në disa raste edhe tre herë gjatë ditës, dhe e kolegëve të tjerë psikologë, nuk ishte e mjaftueshme. Në përpjekjet e pamundura për të krijuar një linjë të dedikuar me operatorë psikologë profesionistë, që do t’u vinin në ndihmë me mbështetje psikologjike qytetarëve, më lindi ideja e përfshirjes së komunitetit të psikologëve në mbështetje psiko-emocionale për qytetarët, nëpërmjet numrave të tyre personalë të telefonit.

Që prej 23 marsit deri në 10 maj 2020, rreth 120 psikologë u angazhuan në nismën “*Psikologët Shqiptarë Online! Shërbim psikologjik pa pagesë*”. Super punë e bërë, e cila gjeti pasqyrim të menjëhershëm në mediat kombëtare dhe portalet online në vend. Puna krejtësisht vullnetare e bërë nga psikologët shqiptarë, nuk do të kalonte pa rënë në sy edhe të kolegëve të huaj. Psikologët italianë dhe britanikë e pasqyruan punën e Urdhrit të Psikologut në artikujt e tyre gjatë këtij viti.

2020-ta ka qenë një vit i çuditshëm, i vështirë, por edhe shumë i bukur dhe me arritje, ndonëse në kushte jo normale. Asgjë nuk do të ishte e mundur pa angazhimin e pakushtëzuar të psikologëve, për të vijuar me sfida dhe arritje rrugëtimin e institucionit tonë.

Pafund krenare për secilin prej Tyre! Janë profesionistë të këtij vendi, që me dashurinë që i karakterizon dhe frymën e grupin, kanë treguar se janë aty, për të dhënë ndihmën e tyre në ditët më të vështira emocionalisht për Shqipërinë.

Përzemërsisht,

Valbona Treska



**URDHRI I PSIKOLOGUT
RAPORTI VJETOR 2020**





1. RRUGËTIMI I INSTITUCIONIT GJATË VITIT 2020

Ndonëse një vit i vështirë në të gjitha dimensionet, kemi vijuar të bëjmë së bashku një rrugë të rëndësishme profesionale. Çdo muaj ka patur aktivitete të vlefshme për komunitetin e psikologëve.

Janar

Ekspierenca e tërmetit të nëntorit 2019 na gjeti të papërgatitur nga ana strukturore dhe e protokolleve të veçanta të reagimit ndaj këtyre situatave, por njëkohësisht, na tregoi se duhet t'i kushtojmë një vëmendje të veçantë trajnimit të psikologëve për rastet e emergjencave. Në këtë kuadër në datë 14 janar, u thirr nga Presidentja Znj.Valbona Treska tryeza e rumbullakët me temë: *"Si mund të ndërtojmë një sistem më të mirë të Shërbimit të Shëndetit Men-*

dor dhe Psiko-Social për Emergjencat". Në të marrën pjesë përfaqësues nga NGO të ndryshme, të cilat ishin aktive në vendet e prekura nga tërmeti në ofrimin e shërbimeve psikologjike, kryesisht për të miturit, por jo vetëm. Nuk munguan as psikologët, të cilët e kanë ofruar këtë shërbim në terren dhe kanë qenë të pakursyer në kontributin e tyre.

Në këtë takim kishim nderin të kishim prezent **Prof.Vitalii Klymchuk** (anëtar i Komitetit të Katastrofave Natyrore dhe Traumave në Federatën Europiane të Psikologëve), i cili ndau me të pranishmit eksperiencën e tij në këtë fushë.





Prezenca e tij i parapriu trajnimit 3 ditor që u zvillua në datat 15, 16 dhe 17 janar me temë **”Menaxhimi i Emergjencave me në fokus Traumën”**. Ky trajnim u realizuar në bashkëpunim me Komisionin e Përhershëm të EFPA-s, të cilët ju përgjigjën menjëherë thirrjes tonë për ndihmë, Universitetin Mesdhetar të Tiranës dhe World Vision Albania.



Pjesëmarrja e psikologëve në trajnimin 3 ditor nga Prof.Vitalii Klymchuk ishte jashtë çdo parashikimi. Në të morën pjesë plot **146** psikologë nga e gjithë Shqipëria.

Ndërkohë në 28 Janar 2020 festuam ditëlindjen e 3-të të Urdhrit. Që prej Asamblesë Themeluese të 28 Janarit 1977,



nuk harrojmë asnjëherë së festuari çdo vit datën e lindjes së institucionit.





Shkurt

Në datat 4-8 shkurt 2020, Urdhri i Psikologut, organizoi për herë të parë Vlerësimin e Aftësisë Praktik (Provimin e Praktikës Profesionale), pas miratimit të Rregullores së Praktikës Profesionale të Psikologut, nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Në

këtë provim morën pjesë 96 psikologë, anëtarë të Urdhrit të Psikologut, të cilët kishin përfunduar ushtrimin e Praktikës Profesionale. Kjo kategori psikologësh janë aktualisht në pritje të zhvillimit të Provimit të Shtetit, në mënyrë që të pajisen me Lejen Individuale të Ushtrimit të Profesionit (Licencë Profesionale).





Shkurti vijoi me ofrimin e trajnimeve të specializuara për psikologët për mënyrën e reagimit dhe trajtimit të individëve në raste emergjencash. Në kuadër të trajnimeve të posaçme për psikologët, u vendosën ura



cializuar në dhënien e emergjencave, veçanërisht në rastet e tërmeteve.

Në kuadër të marrëdhënieve profesionale mes dy institucioneve tona, u firmos "Memorandumi i Bashkëpunimit" nga Presidentja e E.S.P.R.I Maria Fenoglio dhe Presidentja e U.P. Valbona Treska. Firmosja e këtij Memorandumi, i parapriu trajnimit të rradhës në fushën e emergjencave, të realizuar nga një grup ekspertësh në fushë të E.S.P.R.I.

Trajnimi me temë "Ndhima Psikologjike në Situata Emergjente" i realizuar nga Urdhri i Psikologut në bashkëpunim me Universitetin Marin Barleti dhe E.S.P.R.I (Itali), bënë bashkë 8 psikologë dhe



bashkëpunimi dhe u krijua lidhje profesionale me njëjën prej shoqatave të psikologëve më të mëdha në Itali E.S.P.R.I, të cilët janë prej vitesh të spe-

psikiatër italianë nga më të suksesshmit në fushën e emergjencave. Edhe ky trajnim pati një interes shumë të lartë nga profesionistët psikologë dhe shënoi një pjesëmarrje prej **103** psikologësh.



Shkurti vijoi me një nga aktivitetet më të rëndësishme të institucionit. Asambleja e IV Kombëtare e Urdhrit të Psikologu zhvilloi punimet më 28 shkurt 2020 në qytetin e Durrësit.

Nisma për të zhvilluar çdo vit një asamble lëvizëse, e cila shkon ndër vite në çdo qytet ku ka psikologë, këtë vit mbledhi në Durrës kolegë nga e gjithë Shqipëria. Real-

izimi i këtij aktiviteti kombëtar profesional, jo vetëm që promovon rolin e psikologut në qytet, por edhe e fuqizon atë.





vitit 2019. Realizimi i Asamblesë në këtë qytet, ishte një mirënjohje për të gjithë kolegët tanë.

Në këtë kuvend profesionistësh morëm vendime të rëndësishme dhe diskutuam mbi problematika të institucionit dhe profesionit.

U zgjodh pikërisht Durrësi, pasi psikologët e këtij qyteti, të drejtuar nga Koordinatori Lokal i U.P. Z.Elton Kuqja, mbajtën një peshë të jashtëzakonshme gjatë emergjencës së tërmetit. Ndihma e vyer e këtyre psikologëve nuk mund të mos vihej



në fokus të Asamblesë tonë të IV Kombëtare. Durrësi ishte qyteti që mirëpriti gjithashtu psikologë nga e gjithë Shqipëria gjatë ditëve të fundit të



Në ngjarjen më të madhe profesionale të vitit, psikologë nga e gjithë Shqipëria patën gjithashtu mundësinë të qëndrojnë gjatë me njëri-tjetrin, të socializohen dhe të kuptojnë të përbashkëtat e të veçantat e punës në qytete të ndryshme të vendit.



Gjatë punimeve të Asamblesë u bë gjithashtu një paraqitje e punës vjetore të vitit 2019 të Urdhrit dhe organeve të tij.



Gjatë këtij muaji kemi vijuar gjithashtu të jemi aktivë në aktivitete të ndryshme për promovimin e rolit të psikologut. Universiteti i Elbasanit organizoi një takim me aktorë të rëndësishëm të institucioneve me qëllim fuqizimin profesionit.



Mars

Pandemia Covid-19, ndryshoi rrjedhën e të gjithë aktiviteteve tona institucionale, sikundër në të gjithë botën. Aktivitetet e Urdhrit të Psikologut u pezulluan në muajin mars. I gjithë vendi u detyrua të futej në karantinë, për shkak të situatës shëndetësore të krijuar nga pandemia, një situatë e panjohur më parë nga të gjithë dhe e vështirë për t'u përballuar nga ana shëndetësore dhe emocionale. Por edhe pse në pamundësi për të vijuar punën në ambjentet e zyrës, stafi i Urdhrit të Psikologut e vijoj atë pa ndërprerje *online*. U përpoqëm që t'i gjendemi pranë jo vetëm psikologëve, por të gjithë qytetarëve, të cilëve situata e izolimit ju shkaktoi probleme psikologjike.

Thirrjes së Presidentes së U.P. për të ofruar ndihmë, ju bashkuan 130 psikologë nga e gjithë Shqipëria, të cilët vunë në dispozicion të qytetarëve jo vetëm njohuritë e tyre profesionale, por edhe numrat indi-

vidualë të telefonit. Koha ishte shumë e shkurtër dhe nuk na favorizonte për krijimin e një linje të dedikuar për shërbim psikologjik. Nxituam të ofronim ndihmë në kohë rekord dhe në rrethana të paimagjinueshme më parë.

Urdhri i Psikologut, nën moton "*Psikologët Shqiptarë Online! Shërbim psikologjik pa pagesë!*" ofroi shërbim nga e hëna në të shtunë, në dy fasha oraresh 10.00-12.00 dhe 17.00-19.00 nga data 23 mars deri më 10 maj 2020.

Shërbimi psikologjik, i cili ishte i pari që nisi në rajon në këtë formë, u pasqyrua në revistën periodike të Federatës Europiane të Psikologëve, si dhe u përqaftua si model edhe nga vende të tjera të rajonit, të cilët, vlen të theksohet, se edhe pse janë më të shumtë në popullatë, patën përfshirje vullnetare të psikologëve në shifra më të ulta se Shqipëria.

Është kënaqësi të ndajmë me ju faktin se për të dytën herë rradhazi, në një kohë shumë të shkurtër pas tërmetit të 26 nëntorit, komuniteti i psikologëve shqiptarë ka treguar Përgjegjshmëri



dhe vullnet për t'u admiruar, në mënyrën se si ju bashkua menjëherë thirrjes së Presidentes për shërbim vullnetar. Çdo darkë, monitorues të grupeve të vogla me 10-15

lehtësisht në faqen tonë të web-it¹, përmbanë në brendësi të tij të dhëna shumë domethënëse dhe rezultate, të cilat ne mendojmë se janë shtysë e fortë për të

REPUBLIKA E SHQIPËRIE
URDHRI I PSIKOLOGUT

UDHËZIM
Në emër PSIKOLOGËT SHQIPTARË ONLINE
shërbim pa pagesë

Psikologë të licencuar
Dispozicioni përfaqësimi

TEL: 067 1 11 11 11

Emri i Psikologut	Nr. Kontakt
1. ...	067 1 11 11 11
2. ...	067 1 11 11 11
3. ...	067 1 11 11 11
4. ...	067 1 11 11 11
5. ...	067 1 11 11 11
6. ...	067 1 11 11 11
7. ...	067 1 11 11 11
8. ...	067 1 11 11 11
9. ...	067 1 11 11 11
10. ...	067 1 11 11 11
11. ...	067 1 11 11 11
12. ...	067 1 11 11 11
13. ...	067 1 11 11 11
14. ...	067 1 11 11 11
15. ...	067 1 11 11 11
16. ...	067 1 11 11 11
17. ...	067 1 11 11 11
18. ...	067 1 11 11 11
19. ...	067 1 11 11 11
20. ...	067 1 11 11 11
21. ...	067 1 11 11 11
22. ...	067 1 11 11 11

Adresa: ...
Telefon: ...

TEL: 067 1 11 11 11

Emri i Psikologut	Nr. Kontakt
27. ...	067 1 11 11 11
28. ...	067 1 11 11 11
29. ...	067 1 11 11 11
30. ...	067 1 11 11 11
31. ...	067 1 11 11 11
32. ...	067 1 11 11 11
33. ...	067 1 11 11 11
34. ...	067 1 11 11 11
35. ...	067 1 11 11 11
36. ...	067 1 11 11 11
37. ...	067 1 11 11 11
38. ...	067 1 11 11 11
39. ...	067 1 11 11 11
40. ...	067 1 11 11 11
41. ...	067 1 11 11 11
42. ...	067 1 11 11 11
43. ...	067 1 11 11 11
44. ...	067 1 11 11 11
45. ...	067 1 11 11 11
46. ...	067 1 11 11 11
47. ...	067 1 11 11 11
48. ...	067 1 11 11 11
49. ...	067 1 11 11 11
50. ...	067 1 11 11 11
51. ...	067 1 11 11 11
52. ...	067 1 11 11 11
53. ...	067 1 11 11 11
54. ...	067 1 11 11 11
55. ...	067 1 11 11 11
56. ...	067 1 11 11 11
57. ...	067 1 11 11 11
58. ...	067 1 11 11 11
59. ...	067 1 11 11 11
60. ...	067 1 11 11 11
61. ...	067 1 11 11 11
62. ...	067 1 11 11 11
63. ...	067 1 11 11 11
64. ...	067 1 11 11 11
65. ...	067 1 11 11 11
66. ...	067 1 11 11 11
67. ...	067 1 11 11 11
68. ...	067 1 11 11 11
69. ...	067 1 11 11 11
70. ...	067 1 11 11 11
71. ...	067 1 11 11 11
72. ...	067 1 11 11 11
73. ...	067 1 11 11 11
74. ...	067 1 11 11 11
75. ...	067 1 11 11 11
76. ...	067 1 11 11 11
77. ...	067 1 11 11 11
78. ...	067 1 11 11 11
79. ...	067 1 11 11 11
80. ...	067 1 11 11 11
81. ...	067 1 11 11 11
82. ...	067 1 11 11 11
83. ...	067 1 11 11 11
84. ...	067 1 11 11 11
85. ...	067 1 11 11 11
86. ...	067 1 11 11 11
87. ...	067 1 11 11 11
88. ...	067 1 11 11 11
89. ...	067 1 11 11 11
90. ...	067 1 11 11 11
91. ...	067 1 11 11 11
92. ...	067 1 11 11 11
93. ...	067 1 11 11 11
94. ...	067 1 11 11 11
95. ...	067 1 11 11 11
96. ...	067 1 11 11 11
97. ...	067 1 11 11 11
98. ...	067 1 11 11 11
99. ...	067 1 11 11 11
100. ...	067 1 11 11 11

Adresa: ...
Telefon: ...

TEL: 067 1 11 11 11

Emri i Psikologut	Nr. Kontakt
91. ...	067 1 11 11 11
92. ...	067 1 11 11 11
93. ...	067 1 11 11 11
94. ...	067 1 11 11 11
95. ...	067 1 11 11 11
96. ...	067 1 11 11 11
97. ...	067 1 11 11 11
98. ...	067 1 11 11 11
99. ...	067 1 11 11 11
100. ...	067 1 11 11 11

Adresa: ...
Telefon: ...

psikologë, mblodhën të dhënat e ardhura nga telefonatat. Ata i përmbledhën të dhënat e telefonatave në raporte të

nisur ndërtimin e politikave të qëndrueshme sociale mbi shëndetin mendor.

standardizuar dha ja vunë në dispozicion zyrës qendrore të UP, që përmbledhë në një raport të vetëm ditor, të dhënat e ardhura nga gjithë Shqipëria.

Të gjitha të dhënat e përftuara nga ky shërbim, ja vumë në dispozicion institucioneve më të rëndësishme në vend dhe ministrive tona të linjës, me qëllimin për të rritur vëmendjen ndaj problemeve psiko-emocionale, që shfaqë popullata gjatë kësaj periudhe. Realizimi i këtij shërbimi i dha ndër të tjera kohën e nevojshme Ministrisë së Shëndetësisë dhe Çështjeve Sociale, për të ngritur linjën e gjelbër të shërbimit psikologjik mbështetës për qytetarët. Me ngritjen për herë të parë të kësaj linje në Shqipëri, shërbimi vullnetar i psikologëve u ndërpre, për t'u vijuar nga kolegë të tjerë psikologë pranë Ministrisë së Shëndetësisë.

Në gati 50 ditë shërbim pa pagesë, kemi marrë 756 telefonata për konsulta psikologjike. Shifra është e lartë, duke marrë në konsideratë faktorët kulturorë për qasjen ndaj psikologut dhe faktin se një shërbim i tillë kaq masiv, u realizua për herë të parë në vend.

Ne përpunuam me kujdes të gjitha të dhënat e përftuara dhe patëm kënaqësinë të ndajmë me të gjithë psikologët, publikun dhe mediat, rezultatet e një *quasi studimi*, të realizuar nga Urdhri i Psikologut. Ky material, i cili mund të shkarkohet

¹ <https://www.urdhriipsikologut.al/wp-content/uploads/2020/05/Rezultatet-e-perpunuara-te-sherbimit-online-COVID-19-PDF-UP-Maj-2020.pdf>



Gjatë muajit mars jemi angazhuar në vazhdimësi për të punuar materiale dhe përkthyer informacionet që na kanë ardhur nga Federata Europiane e Psikologëve. Një grup psikologësh vullnetarë u angazhuan për të përmbyllur në kohë rekord materialet dhe informacionet, me të cilat do t'i vinim në ndihmë qytetarëve. Gjatë këtij muaji nxorrëm disa materiale të rëndësishme informuese për:

- Ndikimin psikologjik të karantinës dhe si ta zvogëlojmë atë².
- Si të jetojmë më mirë në karantinë³
- Covid-19! Rekomandime psikologjike për gazetarët⁴.

Ky informacion ju shpërnda leketronikisht edhe mediave në vend, ndërkohë që pati një shpërndarje mjaft të gjerë edhe nga vetë gazetarët në rrjetet e tyre. Ky informacion gjeti pasqyrim edhe në shtypin e

shkruar. Gazeta Shqiptare⁵ dhe gazeta të tjera në vend, sollën në vëmendje kujdesin që gazetarët duhet të shfaqnin gjatë asaj periudhe.

- Rekomandime lidhur me fëmijët⁶.
- Ky material morri menjëherë vëmendje të lartë në faqet tona sociale me një shpërndarje të materialit që shkoi në rreth 100 shpërndarje brenda pak orëve. Ai u përkthye dhe u përshtat nga psikologë vullnetarë të Urdhrit të Psikologut dhe synonte t'ju vinte në ndihmë të gjithë prindërve, që u përballen me karantinën për shkak të COVID-19, në raportet e tyre të përditshme me fëmijët.

Prill

Gjatëkëtij muaji rifilluam punën fizikisht pranë zyrave qendrore të U.P. dhe ndërkohë vijuan me takimet shumë të shpeshta online, veçanërisht me Shoqatën Amerikane të Psikologëve e cila krijoi një rrjet mbarëbotëror të të gjitha shoqatave dhe urdhrave të psikologëve.

Qëllimi i takimeve dhe diskutimeve ishte përballja me pandeminë Covid-19. Gjatë këtij muaji vijuan të përpunojmë të dhënat e përfutuara nga telefonatat nga shërbimi “Psikologët Shqiptarë Online! Shërbim psikologjik pa pagesë!”



² <https://www.urdhriipsikologut.al/wp-content/uploads/2020/03/Ndikimi-psikologjik-i-karantine%CC%88s-dhe-si-ta-zvoqe%CC%88loniate%CC%88-U.P.-pdf.pdf>

³ <https://www.urdhriipsikologut.al/wp-content/uploads/2020/03/Si-te-jetojme-me-mire-ne-karantine.-U.P.-pdf.pdf>

⁴ <https://www.urdhriipsikologut.al/wp-content/uploads/2021/05/COVID-19-Rekomandime-psikologjike-per-gazetarët..pdf>

⁵ <https://shqiptarja.com/lajm/gazetarwt-nw-vijwn-e-rezikut-tw-covid19-psikologwt-europeanw-sjellin-materialin->

[kwshillues?fbclid=IwAR1iUKqBzXkzKc9CT8qHY1tJazUywQoxjHQ86e0MVTn42k8r1_hoPOb7cn8](https://shqiptarja.com/lajm/gazetarwt-nw-vijwn-e-rezikut-tw-covid19-psikologwt-europeanw-sjellin-materialin-kwshillues?fbclid=IwAR1iUKqBzXkzKc9CT8qHY1tJazUywQoxjHQ86e0MVTn42k8r1_hoPOb7cn8)

⁶ <https://www.urdhriipsikologut.al/wp-content/uploads/2021/05/COVID-19-Rekomandime-prinderve-per-femijet.pdf>



Presidentja Valbona Treska ka patur gjatë kësaj periudhe prononcime thuajse të përditëshme në median vizive dhe të shkruar, me qëllim dhënien e informacionit dhe qetësimin e popullatës mbi gjendjen e shkaktuar.

Gjatë këtij muaji, kemi vijuar të publikojmë, materiale të cilat u kanë ardhur në ndihmë psikologëve dhe që janë realizuar kryesisht nga Federata Europiane e Psikologëve.

Një grup vullnetar psikologësh përktheu materialin: *“Rregulla në lidhje me këshillimin në internet (on line) Pyetjet dhe Përgjigjet më të shpeshta”* Këtë material e gjeni në faqen tonë të web-it⁷ Shqipëria, si vend anëtarë i EFPA-s, u bë pjesë e pyetësorit mbi konsultat online, të publikuar nga grupi i eHealth. Pyetësi u përkthye në gjuhën shqip dhe u publikua në faqen online të Federatës Europiane më 6 prill 2020. Të gjithë profesionistët psikologë, që u përfshinë me konsulta online, u ftuan të merrnin pjesë në plotësimin e tij.



Nuk kanë munguar shkrimet në shtypin e huaj, mbi shërbimin psikologjik online të psikologëve shqiptarë. Njërin prej tyre, të botuar nga kolegët italianë, e gjeni në faqen tonë të web-it⁸.

Psikologët patën mundësi të merrnin pjesë pa pagesë në disa webinarë të organizuar nga EFPA me në fokus shërbimin psikologjik gjatë pandemisë.

⁷ <https://www.urdhriipsikologut.al/wp-content/uploads/2021/05/Rregulla-ne-lidhje-me-keshillimin-ne-internet-online-Pyetjet-dhe-Pergjigjet-me-te-shpeshta.-Materiali-1.pdf>

⁸ <https://www.urdhriipsikologut.al/wp-content/uploads/2021/05/Artikulli-Igor-Vittale.pdf>



Maj

Gjatë muajit maj, u publikuan rezultatet e përpunuara të shërbimit “Psikologët Shqiptarë online. Shërbim pa pagesë! Covid-19, rezultatet të cilat i u përcollën insitucionit të Kryeministrit dhe ministrive përkatëse.

dhe bie ndesh me të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.



Deklarata e datës 15.05.2020, firmosur nga Presidentja e U.P. Dr.Valbona Treska, u bë publike edhe në media kombëtare e ndërkombëtare, madje këtë lajm e pasqyruan edhe gjigandët mediatikë New York Times⁹. Një ditë pas firmosjes së kësaj deklarate, u kontaktuam edhe nga gazetarët e “Reuters”¹⁰, ku u prononcua lidhur me vendimmarrjen, për ta bërë të



Në prag të 17 Majit, ditës botërore kundër homofobisë dhe transfobisë, Urdhri i Psikologut ka bërë një deklaratë zyrtare mbi ndalimin e Terapisë së Konvertimit nga psikologët shqiptarë për komunitetin LGBTIQ. Në bazë të kërkesës së ardhur nga “Ambasada Pink” në Shqipëri përfaqësuar nga Z. Altin Hazizaj, datë

zbatueshme edhe në vendin tonë, ndalimin e Terapisë së Konvertimit. Artikulli i zgjeruar u publikua në faqen e tyre dhe u bë viral edhe në media të tjera të shkruara. Me firmosjen e kësaj Deklarate, Shqipëria bëhet vendi i 3-të në Europë pas Zvicrës dhe Maltës, që ndalon këtë terapi. Interesimi i gazetarëve mbi këtë deklaratë vijon edhe sot.



11.05.2020, profesionistët e Urdhrit të Psikologut, Presidentja e Urdhrit, së bashku me anëtarët e Këshillit Kombëtarë, vlerësuan se kjo terapi nuk është etike

9 https://www.nytimes.com/aponline/2020/05/16/world/europe/ap-eu-albania-conversion-thera-py.html?fbclid=IwAR3ER3f7ZSGynqg8PaOuLezs7VAqwpJrH_-9noBrU4uwXw4fMugc_rw-PDQ
10 <https://www.reuters.com/article/us-albania-lgbt-health-idUSKBN22U2DU>



Në fund të muajit maj, Presidentja e kontaktuar nga revista periodike psikologjike “InPractice”, e Shoqatës Europiane të Psikologëve të Punës dhe Organizacionalë (EAWOP), publikoi një artikull të zgjeruar mbi ecurinë e këtij profili psikologësh, që ushtrojnë profesionin në Shqipëri. Artikullin e gjeni në faqen zyrtare të web-it të Urdhrit të Psikologut¹¹.

Gjithashtu gjatë këtij muaji, në bashkëpunim me studentë të psikologjisë, të cilët ofruan vullnetarisht ndihmesën e tyre dhe së bashku me administratën e Urdhrit të Psikologut, finalizuan punën për riformatimin e mënyrës së mbajtjes së dosjeve individuale për secilin psikolog. Çdo psikolog që është regjistruar pranë insitucionit tonë, ka në dosjen e tij personale, që nga momenti fillestar i regjistrimit në Urdhër e në vazhdim përgjatë të gjithë rrugëtimit të tij, të gjithë dokumentacionin e nevojshëm profesional, diploma studimi, trajnime, çertifikime, etj. Në një punë mjaft intensive 1 mujore, kemi ndryshuar të gjithë mënyrën e mbajtjes dhe dokumentimit të materialeve për anëtarët e Urdhrit të Psikologut. Ka qenë një punë kolosale me mbi 1600 dosje individuale të standardizuara.



¹¹ <http://www.eawop.org/latest-issue>




Qershor

Vetëm një vit pas anëtarësimit me të drejta të plota në EAWOP (Shoqata Europiane e Psikologëve Organizacionalë dhe të Punës), Shqipëria u përzgjodh ndër të gjitha vendet anëtare, si shqyrtuese e të gjithë dokumentacionit që u paraqit për miratim këtë vit në Asamblenë e Përgjithshme të EAWOP.

Në datë 05.06.2020, u organizua një Webinar, nga Federata Europiane e Psikologëve (EFPA), mbi situatën e Covid-19¹² në të cilën morën pjesë edhe kolegë nga Shqipëria.

veprime konkrete si psikologë, për të mbështetur viktimat dhe për të sensibilizuar komunitetet tona.



Mbledhja e Presidentëve të EFPA-s u mbajt në datë 12.06.2020 në një komunikim online. Presidentja Dr.Valbona Treska bëri një paraqitje të punës së U.P. përgjatë pandemisë COVID-19 dhe objektivave për muajt në vazhdim.

Morëm përgëzime të veçanta nga anëtarët e Këshillit Ekzekutiv të EFPA-s për punën e mirë dhe paraqitjen profesionale përpara vendeve të Europës.

Në datë 20.06.2020 Shqipëria i'u bashkua nismës botërore kundër dhunës në familje, një nisëm kjo nën kujdesin e veçantë të Shoqatës së Psikologëve Amerikanë.



70 organizata psikologësh nga të gjitha vendet e botës, u bashkuan për të ngritur zërin e për të ndërmarrë veprime konkrete kundër Dhunës në Familje, veçanërisht në kohën e pandemisë COVID-19.

Urdhri i Psikologut u bëri thirrje të bashkoheshin të gjithë profesionistët por jo vetëm, me këtë iniciativë botërore dhe të ndërmerrim



¹²

https://efpa.magzmaker.com/covid_19/efpa_webinars



Në këtë takim u diskutua ndër të tjera edhe për veprime konkrete, që secili vend anëtarë duhet të ndërmarrë, për fuqizimin e rolit të psikologut organizacionalë në vend. Edhe pse pandemia ndryshoi planet dhe

Korrik


Në kushtet e Pandemisë, të gjitha aktivitetet e psikologëve në mbarë botën u realizuan online.

Në datë 06.07.2020, u zhvillua në më shumë se dy orë prezantime e diskutime, takimi i Anatarëve të Komitetit të EAWOP (Shoqatës Europiane të Psikologëve të Punës dhe Organizacionalë) i përbërë nga përfaqësues të të gjitha vendeve të Europës.

Takimi i parapriu Kongresit të Psikologëve Organizacionalë që do të zhvillohet në Glasgow, Irlandë në Janar 2021



axhendat e planifikuara për realizimin e këtyre aktiviteteve fizikisht, ne vijuan gjatë këtij viti me të njëjtin përkushtim. Ndonëse aktivitetet u realizuan në forma të reja, ishin njësoj produktive.





Ndërkohë që në korrik nuk ndaluan punën as për rritjen e numrit të vogël të psikologëve në shkolla, të cilët janë përgjegjës në disa raste edhe për 12 shkolla.

Si pasojë edhe e problematikës së ngritur të abuzimeve seksuale në vend, ndërmorëm një tjetër fushatë sensibilizimi në institucionet përkatëse, për shtim të numrit të psikologëve. Pas kërkesave të vazhdueshme dhe ngritjes së shqetësimit thuajse në çdo dalje dhe



Në datë 28.07.2020 u përmbush një nga objektivat më madhorë, për të cilin kemi aspiruar, që nga momenti i krijimit të këtij institucioni, atë të firmosjes së Memorandumit të Bashkëpunimit me Shoqatën e Psikologëve Amerikanë (APA).

Me vendim të Bordit të Drejtuesve të APA-s, në shkurt të këtij viti, u mor vendimi



prononcim publik, jemi tashmë në një situatë, e cila besojmë se, do të ndryshojë plotësisht dhënien e shërbimit psikologjik në shkolla, si dhe rendimentin në punë të psikologëve.

Në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit Sportit dhe Rinisë, Agjensinë e Sigurisë së Cilësisë së Arsimit Parauniversitar si dhe Fakultetin e Shkencave Sociale, Tiranë, gjatë këtij muaji u ngrit grupi i punës dhe punoi për hartimin e fondit të pyetjeve për psikologët, që do të punësoheshin në shërbimin psiko-social në muajt në vijim. Shtimi i numrit të psikologëve në shkolla është një prej arritjeve thelbësore të punës së U.P. gjatë këtij viti.

për firmosjen e Marrëveshjes së Bashkëpunimit mes Shoqatës së Psikologëve Amerikanë (APA) dhe Urdhrit të Psikologut. Me ftesë të APA-s, ishim të ftuar të firmosnim MOU-n (Memorandumin e Bashkëpunimit) në Kongresin e përvitshëm që APA do të realizonte, i cili u shty për shkak të pandemisë globale COVID-19.

Edhe pse, prej marsit të këtij viti, Urdhri i Psikologut ka qenë i përfshirë në të gjitha komunikimet dhe veprimtarinë e APA-s si vend MOU, firmosja e tij u realizua online, në bazë të protokollit të firmosjes së dokumentacionit në distancë në dt.28.07.2020.



Në këtë memorandum u angazhuam bashkarisht për organizimin e aktiviteteve të përbashkëta, shkëmbimin e eksperimenteve, pjesëmarrje në konferenca e kongrese dhe veprimtari të tjera, në interes të profesionit të psikologut.




Insitucioni ynë shpreh të gjithë konsideratën e lartë për Shoqatën e Psikologëve Amerikanë (APA), e cila me një ekspertecë të jashtëzakonshme profesionale shumëvjeçare, është krahdhe mbështetje në rrugëtimin e Urdhrit të Psikologut.


Gusht

Gushti është një muaj pushimesh, për pjesën më të madhe të insitucioneve, por jo për Urdhrin e Psikologut, i cili ka vijuar punën me të njëjtin intesitet edhe gjatë këtij muaji.

Gjatë këtij muaji Dr.Valbona Treska, u ftua të marrë pjesë në Kongresin e Shoqatës së Psikologëve Amerikanë 2020 nga Presidentja e APA-s Dr.Sandy Shullman.



Ftesa erdhi pas nënshkrimit të Memorandumit të Bashkëpunimit mes dy vendeve tona. Edhe pse Kongresi u mbajt këtë vit virtualisht, ishte kënaqësi pjesëmarrja, në këtë Kongres mes psikologëve e profesionistëve, jo vetëm amerikanë, por nga e gjithë bota.



Gjatë muajit gusht, nën kujdesin e veçantë të APA-s (Shoqatës së

Psikologëve Amerikanë), më shumë se 60 shoqata të psikologëve nga e gjithë bota, u bënë



pjesë e hartimit të Deklaratës së Përbashkët Mbarëbotërore, mbi Rëndësinë e Psikologut dhe Rolit të tij në Shoqëri.

Kjo nismë u publikua, nga të gjitha këto shoqata në të gjithë botën në të njëjtën ditë.


Jemi të lumtur, e njëkohësisht të nderuar, që jemi pjesë e punës së liderave globalë në fuqizimin e figurës së psikologut.

Ndërkohë, Urdhri i Psikologut, gjatë këtij muaji ju drejtua zyrtarisht me anë të një qëndrimi të Presidentes¹³, Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), në kuadër

ishite realizimi I diskutimeve mbi problematikat e psikologëve të këtyre qarqeve, si dhe fuqizimin e rolit të psikologut në shoqërinë shqiptare.

Gjatë këtij muaji u organizuar takimet online me psikologët e qarqeve Shkodër, Lezhë, Durrës, Fier dhe Korçë.

Gjithashtu në këtë muaj nga ana e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, filluan procedurat për punësimin e psikologëve të rinj, në Shërbimin Psiko-Social. Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar gjatë muajit Shtator 2020 analizoi numrin



të luftës kundër bullizmit kibernetik, me qëllim ruajtjen e privatësisë dhe të të dhënave personale të individëve.

Shtator

Gjatë muajit shtator, Urdhri i Psikologut

ndërmorri një seri takimesh online me anëtarët e qarqeve të ndryshme në gjithë Shqipërinë. Në fokus të këtyre takimeve

e nxënësve në çdo shkollë, për të përcaktuar nevojat për punonjës të rinj të shërbimit psiko-social.

Në bazë të Urdhërit nr. 344 datë 19.08.2013, “Për ngritjen e Njësisë së

Shërbimit Psiko-Social”, i ndryshuar, u

evidentuar 291 vende shtesë në këtëshërbim, numër i cili pothuajse dyfishoi numrin e punonjësve të këtij shërbimi.

¹³ <https://www.urdhriipsikologut.al/wp-content/uploads/2020/08/Deklarate-AMA.pdf>




Ndërkohë që me iniciativë të Presidentes, gjatë këtij muaji nisi puna për krijimin e Divizioneve të Urdhrit të Psikologut.

Divizionet janë struktura, të ndara sipas fushave të psikologjisë, të cilat duhet të ndihmojnë në zhvillimin e profesionit, p.sh.: në ngritjen dhe zgjidhjen e problematikave për profilin përkatës, hartimin e rregulloreve apo protokolleve të punës, pjesëmarrjen në grupet e punës apo tryezat e rumbullakta për atë profil, takime me psikologët, vlerësimin e nevojave për trajnime, takime kombëtare dhe ndërkombëtare në nivel përfaqësimi të institucionit, si dhe çdo aspekt tjetër pune, që ka lidhje specifiku me atë profil të psikologjisë.

Ndërkohë vijuan me intensitet takimet online dhe grupet e punës me kolegët ndërkombëtarë, nën drejtimin e APA-s, veçanërisht mbi situatën e krijuar nga COVID-19.

Edhe pse shumica e këtyre takimeve është



zhvilluar në orët shumë të vona të natës, apo në orët e para pas mesnate, (për shkak të diferencës në orë me SHBA), kemi qenë të lumtur që kemi punuar të gjithë bashkë në skuadër mbi reduktimin e pasojave psikologjike, që shkaktoi pandemia.





Tetor

Urdhri i Psikologut përgatiti gjatë këtij muaji një përmbledhje rregullash orientuese për ofruesit e Edukimit në Vazhdim. Kjo përmbledhje ka për qëllim t'u vijë në ndihmë të gjithë aktorëve, të cilët janë pjesë e procesit të vlerësimit të aktiviteteve të Edukimit në Vazhdim për psikologët (ofertuesve, ekspertëve, anëtarëve të KEVP, administratës së UP), për të lehtësuar punën e tyre. Kjo është një përmbledhje e shkurtër, bazuar në Rregulloren e Edukimit në Vazhdim, sipas rendit kronologjik të gjithë procesit, nga momenti i aplikimit nga ana e ofertuesit të një aktiviteti të Edukimit në Vazhdim e deri në shpërndarjen e certifikatave për pjesëmarrësit nga ana e ofertuesit. Kjo përmbledhje u miratua nga Komisioni i Edukimit në Vazhdim.




Vijuan gjithashtu takimet online me anëtarët e Urdhrit të Psikologut në qarqet kryesore të vendit, përgjatë gjithë muajit tetor, me psikologët e Qarkut Elbasan, Vlorë, Berat, Fier, Gjirokastër, Dibër dhe Mat. Ka qenë një muaj shumë intensiv gjithashtu me korrespondencën tonë institucionale dhe vijimin e trajtimit të problematikave të komunitetit të psikologëve.

Nëntor

Urdhri i Psikologut, duke parë nevojën për rritje të numrit të punonjësve psikologë në shkolla, ka vijuar me ngulm kërkesën për rritje të profesionistëve në këtë shërbim. Në këto kushte, u bë e mundur nga Drejtorja e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar hapja e konkursit për rekrutimin e psikologëve, për të qenë pjesë e Shërbimit Psiko-Social, në institucionet arsimore. Pas përfundimit të procesit të rekrutimit, u shpallën fitues 182 psikologë, të cilët firmosën kontratat e punësimit e kanë nisur të ushtrjnë funksionin e tyre tashmë, në insitucionet arsimore të ciklit parauniversitar në vendin tonë. Kësaj shifre ju shtua në vazhdim edhe një numër tjetër psikologësh, duke e çuar në **203** në total numrin e psikologëve të punësuar rishtas në sistem.

Në datë 27.11.2020, Presidentja e Urdhrit të Psikologut Znj.Valbona Treska, ishte pjesë e mbledhjes së Presidentëve të EFPA-s, mbledhje kjo e zhvilluar online nëpërmjet platformës ZOOM. Insitucioni ynë, përfaqësuar nga Presidentja Treska, paraqiti punën e





bërë nga U.P. gjatë këtyre muajve lidhur me pandeminë COVID-19, aktivitete të tjera të rëndësishme si dhe përgatitjet që po bëjmë për procedurat e licencës EuroPsy.



Puna e Urdhrit të Psikologut të Shqipërisë gjatë pandemisë, gjeti pasqyrim edhe në artikujt ndërkombëtarë.

Mrs. Ella Rhodes nga British Psychological Society, komunikoi me Presidenten Valbona Treska,

duke paraqitur në vijim në një artikull të plotë punën e bërë nga Urdhri gjatë këtyre muajve. Shkrimin e gjeni të pasqyruar në faqen zyrtare të psikologëve britanikë, British Psychological Society¹⁴.

Gjatë këtij muaji, kemi patur një aktivitet të reduktuar, pasi zyra qendrore e Urdhrit u mbyll, për shkak të infektimit të një pjese të stafit me COVID-19. Hyrje-daljet e antarësisë me gati 80 persona çdo ditë, që kërkonin të pajiseshin me vërtetime si antarë të U.P, sollën dhe infektimin e një pjese të stafit dhe familjeve të tyre, por fatmirësisht pa pasoja të rënda në shëndet.

Dhjetor

Fundviti i Urdhrit të Psikologut, ndër të tjera, është i ngarkuar edhe për shkak të

mbylljes së bilanceve financiare, hartimit të projekt-buxhetit për vitin pasardhës dhe mbledhjeve të Këshillit Kombëtar.

Gjatë dhjetorit kemi realizuar edhe një sërë aktivitete të kemi finalizuar me sukses marrëveshje bashkëpunimi të rëndësishme për forcimin e rolit të psikologut dhe krijimin e lehtësirave në ushtrimin e profesionit.

E kemi nisur muajin dhjetor me nënshkrimin e një Marrëveshje Bashkëpunimi me Postën Shqiptare, me qëllimin e vetëm: lehtësimin e procedurës së kryerjes së pagesave për llogari të Urdhrit të Psikologut nga anëtarësia dhe uljen e kostove për transaksionet financiare të të gjithë anëtarëve të U.P-së.



Ka vijuar puna me nënshkrimin e Marrëveshjes për Forcimin e Drejtësisë Penale për të Mitur në Shqipëri nga Presidentja e Urdhrit dhe një sërë institucioneve të tjera në nivel drejtues dhe ekzekutues në vend në një takim online në datën 02.12.2020. Mbështetja do të jetë 18-mujore, ndaj institucioneve përkatëse dhe fëmijëve në konflikt me ligjin si dhe fëmijëve viktime, apo dëshmitarë të kimit në rrethet Gjirokastrë dhe Berat, nga UNICEF Albania dhe Save the Children,

¹⁴ <https://thepsychologist.bps.org.uk/nonormalcrisis>



financuar nga Ministria e Punëve të Jashtme të Norvegjisë.

Po gjatë muajit dhjetor, Urdhri i Psikologut në bashkëpunim me Policinë e Shtetit, Akademinë e Sigurisë, Programin Pameca V ka përmbyllur me sukses trajnimin 3 ditor të psikologëve në polici, ku morën pjesë psikologë të punësuar në strukturat e policisë në të gjithë Shqipërinë.



vijojmë të llojshmë e punojmë, për të fuqizuar dhe për t'i dhënë sa më shumë zë psikologut në polici.



Po në kuadër të fuqizimit të rolit të psikologut por kësaj here në sistemin e burgjeve


e, në 29.12.2020 firmosëm Marrëveshjen e Bashkëpunimit mes Urdhrit të Psikologut dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve.

Roli i psikologut ka nevojë sot, më shumë se kurrë, të forcohet e lartësohet e ne do të





Në vazhden e identifikimit të profesionistëve që lanë gjurmë këtë vit në profesion, ne kërkuam nga anëtarësia që të propozojnë kolegë për t'u shpallur "Psiko-



logu i Vitit". Ky është një vlerësim simbolik, që synon të promovojë punën e çdo njërit prej anëtarëve. Gara u fokusua në tre emra, të cilët ishin dhe më të nominuarit e anëtarëve, Znj.Valmira Skendi, Znj.Orjola

Morëm përsipër që së bashku t'i japim një tjetër qasje psikologut të burgjeve, të punojmë për të fuqizuar rolin e psikologut



dhe do të ngremë grupe pune për standardizimin e dokumentacionit dhe protokolleve të punës.



Plaku dhe Znj.Florida Aliaj. Votimi përfundimtar shpalli fituese të çmimit



tashmë të kthyer në traditë, “Psikologu i Vitit 2020” psikologjen Orjola Plaku.

Ne kemi patur një vit plot sfida e suksese dhe jemi krenarë për çdo psikolog, që edhe këtë vit të pazakontë e të vështirë nga pan-


demia Covid-19, ditën të jenë profesionistë të mirë e mbi të gjitha njerëz human dhe bashkëpunëtorë të vyer.

Fundviti 2020 shënoi rrugëtimin e vështirë dhe aspak të zakonshëm që bëmë gjatë këtij viti pandemik.





2. ORGANET E URDHRI TË PSIKOLOGUT DHE AKTIVITETI I TYRE FUNKSIONAL GJATË VITIT 2020



Organet kryesore të Urdhrit të Psikologut janë:

- a) Asambleja Kombëtare;
- b) Këshilli Kombëtar;
- c) Presidenti i Urdhrit;
- ç) Komisioni Etik i Gjykimin Disiplinor Profesional
- d) Komisioni i Edukimit në Vazhdim
- e) Komisione të tjera, ku përfshihen aktualisht
- f) Komisioni i Licencimit dhe
- g) Komisioni i Praktikave Profesionale.

2.1 Asambleja Kombëtare

- Organi më i lartë drejtues i Urdhrit të Psikologut, bazuar në ligjin nr. 40/2016, është Asambleja Kombëtare.
- Asambleja Kombëtare përbëhet nga të gjithë anëtarët e Urdhrit të Psikologut.
Asambleja Kombëtare ka këto funksione:
- zgjedh Këshillin Kombëtar dhe Presidentin e Urdhrit, me votim të fshehtë dhe me shumicë të thjeshtë të të gjithë anëtarëve të saj;
- miraton statutin e Urdhrit;
- miraton Kodin e Etikës dhe Deontologjisë;
- miraton rregulloren për gjykimin disiplinor profesional;
- miraton rregulloren për regjistrimin, anëtarësimin dhe licencimin;
- miraton rregulloren për organizimin e praktikës profesionale;
- shqyrton dhe miraton projekt-buxhetin e Urdhrit, si dhe shqyrton buxhetin faktik të tij;
- analizon veprimtarinë vjetore të organeve të Urdhrit;
- shqyrton raportin e auditit të



jashtëm, në intervale tre vjeçare.

Këtë vit, në datë 28.02.2020, në mjediset e “Klajdi Resort” në Durrës, u organizua Asambleja e IV Kombëtare e Urdhrit të Psikologut, në të cilën morën pjesë 94 anëtarë. Kjo Asamble pati rend dite si më poshtë:

- Hapja e punimeve nga Z.Igli Çutra.



- Fjalë përshëndetëse e Koordinatorit Lokal të Qarkut Durrës, Z.Elton Kuqja.
- Përshëndetja e Presidentes së Urdhrit të Psikologut Znj.Valbona Treska dhe analiza vjetore e punës së organeve të këtij institucioni.
- Analizë e situatës financiare të vitit 2019 dhe prezantim i projekt-buxhetit të vitit financiar 2020 nga financieri i Urdhrit të Psikologut, Z.Lejdi Goga.
- Miratimi i buxhetit faktik të vitit 2019, miratuar nga Këshilli Kombëtar i Urdhrit të Psikologut me Vendim Nr.2, datë 30.01.2020.



- Miratimi i projekt-buxhetit të vitit 2020, miratuar nga Këshilli Kombëtar i Urdhrit të Psikologut me Vendim Nr.1, datë 30.01.2020.
- Miratimi i ndryshimeve të Rregullores së Gjykimit Etik e Profesional, miratuar nga Këshilli Kombëtar i Urdhrit të Psikologut me Vendim Nr.4, datë 30.01.2020.
- Hapësirë e lirë për diskutime.

Asambleja u zhvillua me sukses dhe me diskutime konstruktive, duke miratuar të gjithë pikat e rendit të ditës.

Asambleja e IV Kombëtare mori këto vendime:

Këshilli Kombëtar është organi ekzekutiv i Urdhrit, i cili përbëhet nga 16 anëtarë.

Anëtarë të zgjedhur të Këshillit Kombëtar janë:

Dr.Blertha Bodinaku, Dr.Fleura Shkëmbi, Dr.Brunilda Laboviti, Dr.Valbona Habili, Elona Mustafaraj, Dr.Skerdi Zahaj, Rezarta Basha, Gracela Mana, Sonila Meçaj, Denada Toçe, Redina Balla.

Në përbërje të Këshillit Kombëtar janë edhe 4 anëtarë të caktuar nga Ministrinë, përkatësisht nga:

1. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (njëkohësisht edhe Autoriteti Kompetent i Urdhrit të Psikologut sipas ligjit)
2. Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë
3. Ministria e Drejtësisë

- të miratojë me unanimitet nga 94 anëtarë prezent në Asamble, ndryshimet e propozuara në Rregulloren e Gjykimit Disiplinor e Profesional.
- të miratojë Buxhetin Faktik të vitit 2019, me 93 vota pro dhe 1 kundër të anëtarëve prezent në Asamble.
- të miratojë Projekt-Buxhetin e vitit 2020, me 93 vota pro dhe 1 kundër të anëtarëve prezent në Asamble.

2.2 Këshilli Kombëtar

4. Ministria e Mbrojtjes

Këshilli Kombëtar ka këto përgjegjësi:

- a) miraton strukturën e vet organizative;
- b) cakton kuotizacionin dhe tarifat;
- c) administron pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme të Urdhrit në nivel kombëtar;
- ç) mbikëqyr të gjithë veprimtarinë e organeve që varen prej tij;
- d) harton statutin, rregulloret e Urdhrit, si dhe Kodin e Etikës dhe Deontologjisë dhe ia propozon ato për miratim Asamblesë Kombëtare;
- dh) mban dhe përditëson Regjistrin e Urdhrit të Psikologut;
- e) ngre grupe pune *ad-hoc* për kryerjen e kontrolleve në ushtrimin e profesionit të psikologut;
- ë) përgatit dhe publikon raportin vjetor dhe financiar.



Këshilli Kombëtar i Urdhrit të Psikologut të Republikës së Shqipërisë, përgjatë këtij viti, ka patur një aktivitet shumë të ngjeshur.

Gjatë vitit 2020 Këshilli Kombëtar ka marrë vendimet e mëposhtme:

- ✓ Vendim Nr.1, dt.30.01.2020, “ Për miratimin e Projekt-Buxhetit të vitit financiar 2020 ”
- ✓ Vendim Nr.2, dt.30.01.2020, “Për miratimin e Buxhetit-Faktik 2019”
- ✓ Vendim Nr.3, dt.30.01.2020 “Për ngritjen e një komisioni *ad-hoc* për shqyrtimin e ankesës kundër

vendimit të Komisionit të Etikës”, për çështjen disiplinore ndaj psikologes J. D.

- ✓ Vendim Nr.4, dt.30.01.2020 “Për miratimin e ndryshimeve në Rregulloren e Gjykimit Disiplinor e Profesional”
- ✓ Vendim Nr.5, dt.26.02.2020, “Për rrëzimin e ankesës së psikologes J.D.”
- ✓ Vendim Nr.6, dt.09.04.2020, “Për shtyrjen e afatit të pagesës së tarifës së reregjistrimit”
- ✓ Vendim Nr.7, dt.19.05.2020, “Për ndryshimin e tarifave të honorareve të komisioneve”



- ✓ Vendim Nr.8, dt.19.05.2020, “Për miratimin e ndryshimeve në Rregulloren e Edukimit në Vazhdim”
- ✓ Vendim Nr.9, dt.19.05.2020, “Për ngritjen e komisionit të votimit për zgjedhjen e anëtarëve të rinj të Komisionit të Etikës”
- ✓ Vendim Nr.10, dt.29.05.2020, “Për ngritjen e Komisionit të Etikës”
- ✓ Vendim Nr.11, dt.15.06.2020 “Për ngritjen e një komisioni *ad-hoc* për shqyrtimin e ankesës kundër vendimit të Komisionit të Etikës, ndaj psikologut J.D”.
- ✓ Vendim Nr.12, dt.15.06.2020, “Për ndryshimin e strukturës organizative të Urdhrit të Psikologut”.
- ✓ Vendim Nr.13, dt.18.08.2020, “Për rishqyrtimin e kërkesës së psikologut J.D.”
- ✓ Vendim Nr.14, dt.18.08.2020, “Për ngritjen e një komisioni *ad-hoc* për shqyrtimin e ankesës kundër vendimit të Komisionit të Etikës”.
- ✓ Vendim Nr.15, dt.18.08.2020, “Për rrëzimin e ankesës së psikologut I.H.”
- ✓ Vendim Nr.16, dt.21.09.2020, “Për ndryshimin e Vendimit Nr.2 të Komisionit të Etikës”.
- ✓ Vendim Nr.17, dt.21.09.2020, “Për rishqyrtimin e ankesës së psikologes E.M. dhe zëvendësimin e anëtarëve të komisionit të praktikës”
- ✓ Vendim Nr.18, dt.27.10.2020, “Për lënien në fuqi të Vendimit Nr.1, të Komisionit të Etikës”
- ✓ Vendim Nr.19, dt.27.10.2020, “Për ftesë në seancën dëgjimore të psikologes E.M”.
- ✓ Vendim Nr.20, dt.17.12.2020, “Për ndryshimin e Vendimit Nr.6 të Komisionit të Etikës”
- ✓ Vendim Nr.21, dt.17.12.2020, “Për refuzimin e ankesës së Znj.F.K.”
- ✓ Vendim Nr.22, dt.17.12.2020, “Për lënien në fuqi të Vendimit Nr.7, të Komisionit të Etikës”
- ✓ Vendim Nr.23, dt.17.12.2020, “Për miratimin e Projekt-Buxhetit të vitit financiar 2021”

2.3 Komisioni i Gjykimit Disiplinor Profesional

Ky komision është ngritur pranë Urdhrit të Psikologut në zbatim të Nenit 19 të Ligjit nr. 40/2016 “Për Urdhrin e Psikologut në Republikën e Shqipërisë”.

Komisioni i Gjykimit Disiplinor dhe Profesional ka pësuar ndryshime në strukturën e tij të organizimit. Këshilli Kombëtar mori vendimin Nr.4,dt.30.01.2020 “Për miratimin e ndryshimeve në Rregulloren e Gjykimit

Disiplinor e Profesional që në strukturën e tij të jenë 5 anëtarë, nga të cilët 4 anëtarë të jenë profesionistë nga fusha e psikologjisë dhe 1 anëtar nga Zyra Juridike e Urdhrit të Psikologut. Ky vendim ju propozua Asamblesë Kombëtare të Urdhrit të Psikologut mbajtur në datë 28.02.2020 dhe u miratua nga kjo Asamble me vendim nr.1, datë 28.02.2020.



Ndryshimi për strukturën e Komisionit të Gjyimit Disiplinor dhe Profesional hyri në fuqi menjëherë pas miratimit nga Asambleja.

Këto ndryshime u kryen, për t'i dhënë më shumë stabilitet punës së këtij komisioni dhe asistencë juridike, duke bërë pjesë të komisionit një jurist nga Zyra Juridike e Urdhrit të Psikologut. Kjo, për shkak se në gjykimet e mëparshme nga Komisioni Etik, një element i tillë është parë shumë i nevojshëm në vijueshmërinë e punës së këtij komisioni. Këshilli Kombëtar ka vendosur t'i adresojë këto problematika duke bërë ndryshimet e nevojshme në Rregulloren e Gjyimit Disiplinor Profesional dhe duke përfshirë në Komisionin e Komisioni funksionon në bazë të ligjit për Urdhrit të Psikologut, Kodit të Etikës dhe



Deontologjisë si dhe Rregullore s të Gjyimit Disiplinor e Profesional. Gjatë vitit 2020 Komisioni Etik i Gjyimit Disiplinor Profesional ka shqyrtuar 10 raste, të iniciuara nga individë të ndryshëm ose edhe kryesisht nga Presidentja e Urdhrit në raste sensitive që kanë tërhequr vëmendjen e opinionit publik.

Etikës një jurist nga administrata e Urdhrit të Psikologut. Juristi do të jetë përgjegjës për mbarëvajtjen e punës së komisionit nga ana procedurale dhe ligjore, duke ndihmuar kështu cilësinë e gjyimit.

Anëtarë të zgjedhur me mandat 4 vjeçar të Komisionit Etik janë:

- ✓ Dr.Enila Cenko
- ✓ Dr.Jonida Haxhiu
- ✓ Dr.Brunilda Laboviti
- ✓ Znj.Redina Balla

Z.Igli Çutra është anëtarë i komisionit në cilësinë e juristit të U.P.

Komisioni i Etikës, pas shqyrtimit të rasteve ka dhënë këto vendime:

- Në 7 raste janë konstatuar shkelje të Kodit të Etikës dhe janë dhënë masa të ndryshme disiplinore kundrejt psikologëve të tilla si: Përgjashtim nga U.P. për një periudhë nga 3 deri në 24 muaj, në varësi të shkeljes së konstatuar.
- Në 3 raste, pas shqyrtimit të çështjes, Komisioni Etik nuk ka konstatuar raste të shkeljes së Kodit të Etikës, ndaj kërkesat e palëve ankuese janë rrëzuar.





2.4 Komisioni i Edukimit në Vazhdim në Psikologji.

Në bazë të Pikës 40.3 të Statutit të Urdhrit të Psikologut, ky Komision zgjidhet nga Këshilli Kombëtar dhe drejtohet nga Presidentja e Urdhrit, njëkohësisht anëtare e këtij komisioni.

Në përbërje të tij janë gjithashtu anëtarët:

- Prof.Dr.Theodhori Karaj
- Prof.As.Dr.Zenel Orhani,
- Prof.As.Dr.Erika Mellonashi,
- Dr.Marsela Shehu.

Pas krijimit të tij dy vite më parë, dhe pas plotësimit të të gjitha akteve normative që e bënë këtë komision funksional, u vijua puna normalisht edhe gjatë vitit 2020. Janë shqyrtuar aplikimet për akreditim dhe kërkesa për ripërsëritje të aktiviteteve të subjekteve, të cilat ishin të interesuara të kryenin aktivitete të akredituara të edukimit në vazhdim në psikologji. Gjatë vitit 2020 nga ky komision janë marrë vendimet e mëposhtme:

- ✓ **Vendim Nr.1, datë 23.04.2020:**
 - Të pranohen aplikime për trajnime online, me platforma të specifikuara paraprakisht, deri në përfundim të gjendjes së jashtëzakonshme për shkak të Covid-19”.
 - Të akreditojë trajnimin e Qendrës së Këshillimeve Psikologjike, Shkodër me temë: “Prindërimi pozitiv me fokus fëmijët 0-12 vjeç”.
 - Të akreditojë trajnimin me temë: “Ndërhyrjet psikologjike tek fëmijët dhe adoleshentët. Trajnimi i shëndetit mendor sipas

perspektivës me familjen në qendër”, nga Qendra e Këshillimeve Psikologjike, Shkodër.

- Të akreditojë trajnimin me temë: “Shëndeti mendor dhe mirëqenia psikologjike e fëmijës” nga Qendra e Këshillimeve Psikologjike, Shkodër.
 - Miratimin e krediteve, për aktivitetin e kryer nga qendra “Inner Life”, me temë: “Trajnimi e teknikave Mindfulness”, me 12 kredite, zhvilluar në datë 20-21 Nëntor 2019.
 - Miratimin e krediteve, për aktivitetin e kryer nga Qendra e Këshillimeve Psikologjike, Shkodër zhvilluar në datë 14-15 Dhjetor 2019 me temë: “Shëndeti mendor dhe mirëqenia psikologjike e fëmijës”, me 10 kredite.
 - T’u japë mundësinë qendrave që kanë aplikuar, të plotësojnë dokumentacionin dhe të përshtasin programin për platformën online.
- ✓ **Vendim Nr.2, datë 20.07.2020**
 - Miratimin e krediteve, për aktivitetin e kryer nga Qendra e Këshillimeve Psikologjike, Shkodër, zhvilluar në datat 8-9 Shkurt 2020, me temë: “Ndërhyrjet Psikologjike te fëmijët dhe adoleshentët”, me 10 kredite.
 - Miratimin e krediteve, për aktivitetin e kryer nga Qendra e Këshillimeve Psikologjike, Shkodër, të zhvilluar në datat 18-19 Janar 2020, me temë: “Prindërimi pozitiv me në fokus fëmijët 0-12 vjeç”, me 10 kredite.



- Miratimin e krediteve, për aktivitetin online të kryer nga Qendra e Këshillimeve Psikologjike Shkodër, të zhvilluar në datat 2-3 Maj 2020 me temë: “Prindërimi pozitiv me në fokus fëmijët 0-12 vjeç”, me 10 kredite.
 - Miratimin e krediteve, për aktivitetin online të kryer nga Qendra e Këshillimeve Psikologjike Shkodër, zhvilluar në datat 16-17 Maj 2020, me temë: “Ndërhyrjet psikologjike të fëmijët dhe adoleshentët”, me 10 kredite.
 - Miratimin e krediteve, për aktivitetin e kryer nga Qendra e Këshillimeve Psikologjike Shkodër, zhvilluar online në datat 30-31 Maj 2020, me temë: “Shëndeti mendor dhe mirëqenia psikologjike e fëmijës”, me 10 kredite.
- ✓ **Vendim Nr.3 datë 10.09.2020**
- Miratimin e krediteve, për aktivitetin e kryer nga qendra “Inner Life” zhvilluar në datë 1-8 Dhjetor 2019, me temë: “Analizat sasiore dhe cilësore e të dhënave në kërkimin shkencor në shkencat sociale”, me 18 kredite.
 - Të akreditojë aktivitetin e Qendres për Trajnim dhe Mbështetje Shkollore “Faik Konica” me temë: “Terapia e artit në vlerësimin dhe trajtimin psikologjik të fëmijëve”.
 - Të akreditojë aktivitetin e Qendres për Trajnim dhe Mbështetje Shkollore “Faik Konica” me temë: “Trajnim mbi përdorimin e instrumentave psikometrike në praktikën profesionale” .
- Të akreditojë aktivitetin e Qendres për Trajnim dhe Mbështetje Shkollore “Faik Konica” me temë: “Vlerësimi psikologjik të fëmijët në moshën shkollore”
 - Të akreditojë aktivitetin e Qendrës për Trajnim dhe Mbështetje Shkollore “Faik Konica” me temë: “Çrregullimi i varësisë dhe abuzimit me substancat”.
 - Të akreditojë aktivitetin e Klinikës Psikologjike “Urtësia” me temë: “Zhvillimi psiko-social i fëmijës”.
 - Të akreditojë aktivitetin e Klinikës Psikologjike “Urtësia” me temë: “Trauma dhe çrregullimi i stresit post-traumatik: Diagnoza, rrjedha dhe trajtimi”.
 - Të akreditojë aktivitetin e Klinikës Psikologjike “Urtësia” me temë: “Psikoterapia Konjitive Bihejviorale përmes internetit për depresionin”.
 - Përzgjedhja e kandidatëve në pozicionin e ekspertëve të Edukimit në Vazhdim.
- ✓ **Vendim Nr.4 datë 22.10.2020**
- Plotësim i dokumentacionit të Qendrës së Trajnimit dhe Mbështetjes shkollore “Faik Konica”: “Trajnim mbi përdorimin e instrumentave psikometrike në praktikën profesionale”
 - Të akreditojë aktivitetin të Klinikës Psikologjike “Butterfly” me temë: “I care – dëgjimi, kuptimi, edukimi: kombinimi i përkujdesjes”, me 5 kredite.
 - Të akreditojë aktivitetin të Klinikës Psikologjike “Butterfly” me temë: “I care – dëgjimi, kuptimi,



- edukimi: kombinimi i përkujdesjes”, me 12 kredite.
- Miratimin e krediteve për aktivitetin të Institutit të Shërbimeve Psikologjike për Komunitetin ISHPK, me temë: “Njohja dhe trajtimi i çrregullimeve sjellore tek fëmijët dhe adoleshentët”, me 8 kredite.
 - Miratimin e krediteve për aktivitetin e Institutit të Shërbimeve Psikologjike për Komunitetin ISHPK, me temë: “Programi PBS për trajtimin dhe menaxhimin e sjelljeve problematike”, me 8 kredite.
 - Miratimin e krediteve për aktivitetin e Institutit të Shërbimeve Psikologjike për Komunitetin ISHPK, me temë: “Grup rishikimi për psikopatologjinë e të rriturve, çrregullimet e personalitetit” me 20 kredite.
 - Miratohet “Përmbledhja e rregullave të Rregullores së Edukimit në Vazhdim”.
 - Miratohet me shumicë votash se numri i aplikimeve për aktivitete për akreditim lidhur me Edukimin në Vazhdim në të njëjtën periudhë kohore, të mos jenë më shumë se 2 aktivitete për çdo Ofertues.
 - Në bazë të rekomandimeve të ardhura nga ekspertja Znj.Anisa Asllanaj, u vendos që për aktivitetet online, të mos tejkalohet numri prej 30 pjesëmarrësish.
- ✓ **Vendim Nr.5 datë 21.12.2020**
- Plotësim i dokumentacionit të EMDR Albania me materialin Word të trajnimit dhe të specifikohet vendi ku do të zhvillohet ai, për aktivitetin me temë: “Vlerësimi psikodiagnostik i fëmijëve në moshën shkollore”.
 - Plotësim i dokumentacionit të QKSHP, aneksi i konfliktit të interesit dhe materialet Word të trajnimit sipas standardeve shkencore të APA-s, për aktivitetin me temë: "Çrregullimet e të nxënësve të fëmijët 0-5 vjeç"
 - Plotësim i dokumentacionit të QKSHP, aneksi i konfliktit të interesit dhe materialet Word të trajnimit sipas standardeve shkencore të APA-s, për aktivitetin me temë: "Stresi në punë".
 - Miratimin e akreditimit të aktivitetit të shoqatës “Të degjoj 366”, me temë: “Autizmi si kompleks neurobiologjik” me 4 kredite.
 - Miratimin e akreditimit të aktivitetit të shoqatës “Të degjoj 366”, me temë: “Raporti i vlerësimit psikologjik”, me 10 kredite.
 - Plotësimi i dokumentacionit të QKSHP për trajnimin e përsëritur me temë: “Ndërhyrjet psikologjike te fëmijët dhe adoleshentët”.
 - Miratimin e krediteve për aktivitetin e Qendrës së Trajnimit dhe Mbështetjes shkollore “Faik Konica” zhvilluar në datë. 10.10.2020 me temë: “Trajnim mbi përdorimin e instrumentave psikometrikë në praktikën profesionale” me 5 kredite.
 - Miratimin e krediteve për aktivitetin e Qendrës së Trajnimit dhe Mbështetjes shkollore “Faik



Konica” zhvilluar në datë 17.10.2020 me temë: “Terapia e artit në vlerësimin dhe trajtimin psikologjik të fëmijëve”, me 5 kredite.

- Miratimin e krediteve për aktivitetin e Qendrës së Trajnimit dhe Mbështetjes shkollore “Faik Konica” zhvilluar në datë 07.11.2020 me temë: “Çrregullimi i varësisë dhe abuzimit me substancat”, me 5 kredite.
- Miratimin e krediteve për aktivitetin e Klinikës Psikologjike “Butterfly” zhvilluar në datë 19, 21 dhe 23 Nëntor 2020 me temë: “I care – dëgjimi, kuptimi, edukimi: kombinimi i përkujdesjes”, me 12 kredite.
- Miratimin e krediteve për aktivitetin e ISHPK, zhvilluar në datë 7 dhe 8 Nëntor 2020 me temë: “Programi PBS për trajtimin dhe

menaxhimin e sjelljeve problematike”, me 8 kredite.

- Plotësimin e Vlerësimit Përfundimtar të aktivitetit të Miratimit të krediteve për aktivitetin e ISHPK, me temë: “Njohja dhe trajtimi i çrregullimeve sjellore tek fëmijët dhe adoleshentët”
- Miratimin e krediteve për aktivitetin e Klinikës Psikologjike “Urtësia” zhvilluar në datë 04.12.2020 me temë: “Zhvillimi psiko-social i fëmijës” me 5 kredite.
- Miratimin e krediteve për aktivitetin e Klinikës Psikologjike “Urtësia” zhvilluar në datë 06.11.2020 me temë: “Trauma dhe çrregullimi i stresit post-traumatik: Diagnoza, rrjedha dhe trajtimi” me 5 kredite.

2.5 Administrata e Urdhrit të Psikologut

Urdhri i Psikologut vijon të ketë një numër të vogël punonjësish, për shkak të të ardhurave të ulta financiare, të cilat nuk lejojnë zgjerimin e administratës në bazë të nevojave aktuale. Gjatë këtij viti, për shkak të pamundësisë për të ndjekur punët online, të cilat kanë ardhur duke u rritur mjaft në volum, duke përfshirë regjistrat elektronikë dhe faqen e web, arritëm të shtojmë me kohë pune part-time një punonjës IT.

Administrata e Urdhrit të Psikologut përbëhet nga:

- Sekretariati, Protokolli, Arshiva – një punonjëse, Znj. Armira Baboçi
- Zyra Juridike – një punonjës, Z. Igli Çutra
- Zyra e Financës – një punonjës, Z. Lejdi Goga
- Zyra e IT-së – një punonjës part-time, Z. Enn Tusha



2.6 Komisione të tjera

Pranë Urdhrit të Psikologut funksionojnë disa komisione të tjera, të cilat janë të domosdoshme për realizimin e misionit të tij.

2.6.1 Komisioni i Licencimit

Ky Komision është ngritur nga Këshilli Kombëtar i Urdhrit të Psikologut dhe shqyrton kërkesat për licencim të të gjithë atyre psikologëve, që në bazë të ligjit dhe akteve normative në fuqi, përjashtohen nga detyrimi për kryerjen e praktikës profesionale dhe provimit të shtetit dhe pajisen menjëherë me lejen e ushtrimit të profesionit (licencën).

Ai përbëhet nga Presidentja Znj.Valbona Treska, juristi Z.Igli Çutra, si dhe nga



anëtarët e Keshillit Kombëtar: Dr.Skerdi



Zahaj, Znj.Sonila Meçaj dhe Znj.Graciela Mana.

Gjatë vitit 2020 ky komision ka licencuar 101 psikologë të rinj, të ndarë sipas fushave të mëposhtme:

- ✓ Psikologë klinikë - 32 anëtarë
- ✓ Psikologë shkollorë dhe organizacionalë - 7 anëtarë
- ✓ Psikologë këshillimi - 18 anëtarë
- ✓ Psikologë të përgjithshëm - 2 anëtarë
- ✓ Psikologë shkollorë - 27 anëtarë
- ✓ Psikologë në institucione - 5 anëtarë
- ✓ Psikologë ligjorë - 3 anëtarë
- ✓ Psikologë në orientim profesional - 1 anëtar
- ✓ Psikologë organizacionalë - 7 anëtarë
- ✓ Psikologë në kërkim psikologjik - 1 anëtar
- ✓ Psikologë edukimi - 1 anëtar
- ✓ Psikologë zhvillimi -1 anëtar
- ✓ Psikologë socialë, të punës dhe komunitetit – 1 anëtar

2.6.2 Komisioni i Praktikës Profesionale

Ky komision është ngritur nga Këshilli Kombëtar për efekt të zbatimit të “Rreg-



ullores së Praktikës Profesionale”, që është miratuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në cilësinë e autoritetit kompetent dhe Ministria e Arsimit. Kjo rregullore mundëson zbatimin ligjor të procedurave për një numër të konsiderueshëm psikologësh të sapodiplomuar dhe përjashtimin nga kjo praktikë për një kategori tjetër psikologësh.

Komisioni i Praktikës Profesionale drejtohet nga Presidenti i Urdhrit dhe përbëhet nga anëtarët e zgjedhur nga Këshilli Kombëtar, konkretisht: Dr. Brunilda Laboviti, Znj. Redina Balla, Znj. Aleksandra Puçi, si dhe nga juristi i Urdhrit të Psikologut, Z. Igli Çutra.

Pas dorëheqjes së dy anëtareve të Këshillit Kombëtar Znj. Redina Balla dhe Znj. Brunilda Laboviti, është bërë zëvendësimi i tyre. Anëtarët e reja të Komisionit të Praktikës u zgjodhën me vendim të Këshillit Kombëtar Znj. Gracela Mana dhe Znj. Valbona Habli.

Këtë vit janë regjistruar pranë Urdhrit të Psikologut 122 praktikantë me kontrata të rregullta punësimi në institucione të

ndryshme publike dhe jopublike. Komisioni i Praktikës ka shqyrtuar gjatë vitit 2020 dosjet e 28 psikologëve dhe pas shqyrtimit të tyre ka vendosur:

- 5 psikologë të përjashtohen nga detyrimi i kryerjes së praktikës profesionale, bazuar në Memorandumin e Bashkëpunimit mes Urdhrit të Psikologut dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.
- 1 psikolog të vlerësohet nga Komisioni i Licencimit.
- 15 psikologë të kryejnë praktikë të pjesshme profesionale.
- 6 psikologë të kryejnë praktikën e plotë profesionale.

2.6.3 Komisioni i Vlerësimit të Aftësisë Praktik

Ky komision është ngritur bazuar në Urdhrin Nr.580, datë 31.07.2019 “Për ngritjen e Komisionit të Vlerësimit e Aftësimin Praktik për Profesionin e Psikologut” të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe ka si qëllim të vlerësojë praktikën profesionale të supervizuar të çdo psikologu që i nënshtrohet kësaj procedure.

Bazuar në nenin 17 të Urdhrit të përbashkët të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Ministrisë së Shëndetësisë, “Për miratimin e Rregullores së Praktikës Profesionale” anëtarët e këtij komisioni janë si më poshtë: Znj. Aleksandra Puci, kryetare e komisionit dhe përfaqësuese e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Z. Besmir Frroku dhe Z. Edvin Lame, përfaqësues të Urdhrit të Psikologut.



Komisioni hartoi fillimisht pyetjet orientuese për provimin e praktikës profesionale, pyetje të cilat u publikuan paraprakisht në website-n e Urdhrit të Psikologut¹⁵, sipas afateve të parashikuara në rregullore.

Në datat 4, 5, 6, dhe 7 shkurt u zhvillua për herë të parë Provimi i Vlerësimit të Aftësisimit Praktik në formën e një vlerësimi pyetje-përgjigje verbale. Ky vlerësim u realizua pranë zyrave të U.P dhe në të morën pjesë 96 psikologë.

Pas vlerësimit nga KVAP të gjithë kandidatët rezultuan “Kalueshëm” në këtë provim.

Rezultatet e provimit ju komunikuan secilit prej tyre në rrugë zyrtare si dhe u komunikuan pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Cështjeve Sociale. Pas përfundimit të këtij provimi, kandidatët do të vijojnë me realizimin e provimit të shtetit.

¹⁵ <https://www.urdhriipsikologut.al/fondi-i-pyetjeve/>

2.7 Koordinatorët Lokalë

Ky rrjet ka si qëllim ofrimin e mbështetjes, ndihmës dhe mbrojtjes së interesave për të gjithë anëtarët e Urdhrit të Psikologut të rajonit përkatës, duke patur në fokus nevojat dhe problematikat, që ata ndeshin gjatë ushtrimit të profesionit.

Koordinatori lokal ka si mision:

- Kryerjen e shërbimeve për anëtarët e Urdhrit, në kuadër të shpërndarjes efektive të informacioneve, që lidhen me ushtrimin e profesionit, mbledhjes dhe shpërndarjes së dokumentacionit specifik, me qëllim përmirësimin e cilësisë së ushtrimit të profesionit të psikologut në institucionet përkatëse rajonale dhe uljen e kostove për përfitimin e këtyre shërbimeve për anëtarët e Urdhrit në rajon.
- Vendorsjen dhe ruajtjen e marrëdhënieve të Urdhrit me organet vendore dhe subjektet e tjera publike dhe private në rajon, me qëllim rritjen e ndikimit dhe faktorizimin e Urdhrit të Psikologut.

Disa nga funksionet që kryejnë Koordinatorët Lokalë janë:

- Dhënia e informacionit të detajuar për çdo psikolog, i cili do të kryejë procedurat e anëtarësimit, licencimit, zhvillimit të praktikës profesionale, provimit të shtetit, kryerjen e trajnimeve të ndryshme, etj.
- Mbledhja e të gjitha dokumentave të nevojshme të psikologëve të rajonit përkatës, përsa i përket procedurës së anëtarësimit-licencimit, si dhe të çdo dokumenti tjetër, që



lidhet me Urdhrin, dhe përcjellja e tyre pranë Urdhrit të Psikologut.

- Shpërndarja për psikologët e rajonit përkatës të lejes së ushtrimit individual të profesionit (Licencave Profesionale) apo e çdo dokumentacioni tjetër të lëshuar nga Urdhri për anëtarët e këtij rajoni.
- Krijimi dhe ruajtja e marrëdhënieve të bashkëpunimit, brenda rajonit, me institucionet publike, si dhe me çdo subjekt tjetër publik apo privat, që ka qëllime të përbashkëta me Urdhrin e Psikologut.
- Informimi i psikologëve të rajonit lidhur me vendimet dhe udhëzimet e Urdhrit të Psikologut.
- Mbështetja për organizimin dhe zhvillimin e veprimtarive studimore e shkencore në fushën e psikologjisë në rajon.
- Gjithashtu, Koordinatorët Lokalë pranojnë çdo ankesë të ardhur në drejtim të psikologëve, së bashku me të gjithë dokumentacionin shoqëruar, dhe e dërgojnë atë pranë Zyrës Qendrore të Urdhrit të Psiko-

logut, me qëllim inicimin e procedurave të shqyrtimit nga Komisioni i Gjykitimit Disiplinor Profesional.

Aktualisht, shpërndarja e rrjetit të 5 koordinatorëve lokalë në vend, është si më poshtë:

1. Koordinatori Lokal për Qarkun e Lezhës:

Z.Besmir Frroku

Adresa: Blv. "Gjergj Fishta", Godina Nr.4, Kati 2, Lezhë

Tel.: 0693930434 ,

e-mail: besmir.frroku@hotmail.com

2. Koordinatori Lokal për Qarkun e Korçës:

Z.Andi Petro

Adresa: Qendra e Shëndetit Mendor, Korçë

Tel.: 0695303133,

e-mail: andipetro.al@gmail.com

3. Koordinatori Lokal për Qarkun e Fierit:

Znj.Silvana Duka

Adresa: Lagjia "29 Nentori", Rr: "Pinellopi Pirro", Pall: "Arditi 06" (mbi Ecomarket),

Kati I 3-të, Qendra "Epoka e re", Fier

Tel.: 0692436900,

e-mail: silvi_kostrica@yahoo.com

4. Koordinatori Lokal për Qarkun e Durrësit:

Z.Elton Kuqja

Adresa: Rr. "Sefer Efendiu", Objekt 22/11, Durrës

Tel.: 0693110878,

e-mail: elton_kuqja@yahoo.it.

5. Koordinatori Lokal për Qarkun e Shkodrës

Z.Altin Nika





Adresa: Rruga Hysej, Dugajet e Reja, ish-godina e shkollës "Zani Shkodrës"

Tel.: 0684420000 ,
e-mail: altinnika@yahoo.com

3. Anëtarësia e Urdhrit të Psikologut

Për të qenë anëtar i Urdhrit të Psikologut në Republikën e Shqipërisë, psikologët duhet të përmbushin kriteret e mëposhtme:

- të jenë shtetas shqiptarë;
- të kenë diplomën e studimeve të larta “Bachelor” dhe “Master shkencor” ose “Master profesional” në psikologji ose ekuivalent me të, sipas legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë, lëshuar nga institucioni i arsimit të lartë, brenda apo jashtë vendit, të njohura nga ministria përgjegjëse për arsimin;
- të zotohen me shkrim se do të zbatojnë kërkesat e legjislacionit në fuqi, statutit dhe Kodin e Etikës dhe Deontologjisë;

Licencimi i psikologëve rregullohet në bazë të Ligjit “Për Profesionet e Rregulluara në Republikën e Shqipërisë”. Sipas këtij ligji dhe rregulloreve në fuqi të U.P., pas përmbajtjes së studimeve Bachelor dhe Master në psikologji, duhet të kryhet praktika një vjeçare profesionale dhe më pas të jepet provimi i shtetit, si parakusht për licencimin.

Përjashtimisht, në këtë ligj parashikohet se psikologët, të cilët e kanë ushtruar profesionin përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, përjashtohen nga detyrimi për të dhënë provimin e shtetit.

Përpos kësaj kategorie të cilën komisioni ka vijuar ta lincencojë që prej vitit 2017, gjatë këtij viti u shtua për licencim edhe

- të mos jenë të dënuar me vendim gjykatë të formës së prerë për kryerjen e një veprë penale, që lidhet me ushtrimin e profesionit, në momentin e kërkesës për anëtarësim

Anëtarësia ka patur një rritje gjatë vitit 2020, por jemi optimist që do të vijojë të rritet edhe gjatë vitit 2021. Administrata e Urdhrit në vazhdimësi ka bërë një punë të madhe sensibilizuese kundrejt psikologëve, por edhe kundrejt institucioneve publike e jopublike, të cilat janë ndërgjegjësuar për nevojën e zbatimit të ligjit.

Në total Urdhri i Psikologut ka arritur në vitin 2020 në 1187 anëtarë të regjistruar.

3.1 Psikologë të licencuar

një kategori tjetër psikologësh, të cilët kanë ushtruar profesionin përpara hyrjes në fuqi të Ligjit për U.P. dhe kanë patur në atë kohë minimalisht njërin prej cikleve të studimit në psikologji.

Komisioni i Licencimit, duke marrë për bazë vendimin e ardhur nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me Nr.493 (80-2020-528), datë 17.02.2020, në lidhje me psikologjen Znj.Eglantina Nikollaj, vendosi të shqyrtojë dhe të aprovojë Lejen Individuale për Ushtrimin e Profesionit të Psikologut (Licencën Profesionale) edhe për kategorinë e psikologëve të cilët kanë përfunduar një cikël studimi në psikologji përpara hyrjes në fuqi të ligjit dhe kanë ushtruar profesionin si psikolog



para hyrjes në fuqi të ligjit 40/2016 për U.P.

Në këto kushte, në përmbushje të detyrimeve ligjore, Urdhri ka vijuar procesin e licencimit për këtë kategori të psikologëve, bazuar në Ligjin Nr.10171, datë 22.10.2009, “Për profesionet e rregulluara në R.Sh¹⁶ dhe Memorandumin e Bashkëpunimit mes ish-Ministrisë së Mirëqënies Sociale dhe Rinisë dhe Urdhrit të Psikologut.

Aktualisht , licencimi i psikologëve sipas fushës së kompetencës paraqitet si më poshtë:

¹⁶ Neni 9 i Ligjit Nr.10 171, datë 22.10.2009 “Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë” (i nryshuar), pika 4.: Përfshihet nga detyrimi për të dhënë provimin e shtetit: a) profesionisti që, në çastin e hyrjes në fuqi të këtij ligji, ushtron ose ka ushtruar një profesion të rregulluar.



Psikologë të licencuar sipas viteve	2017	2018	2019	2020	Total
Total të Licencuar	307	175	71	101	654
Psikologë Klinikë	147	97	32	32	308
Psikologë Shkollorë Organizacionalë	48	19	14	7	88
Psikologë Shkollorë	28	14	3	27	72
Psikologë Organizacionalë	8	13	2	7	30
Psikologë në Institucione	17	6	3	5	31
Psikologë në Orientim Profesional	9	3	2	1	15
Psikologë në Këshillim Psikologjik	41	25	9	18	93
Psikologë në Kërkim Psikologjik	5	2	2	1	10
Psikologë Ligjorë	5	2	2	3	12
Psikologë të Përgjithshëm	8	2	6	2	18
Psikologë Komuniteti	2	-	-	1	3
Psikologë në Rehabilitim psikologjik	1	-	-	-	1
Psikologë Edukimi	-	-	-	1	1
Psikologë Zhvillimi	-	-	-	1	1

4. Ndërtimi i Regjistrimit Elektronik Online

Një nga detyrat ligjore të Këshillit Kombëtar është ngritja dhe ndërtimi i një regjistri elektronik on-line, në të cilin të pasqyrohen të dhënat e aksesueshme për publikun për çdo psikolog. Ky proces ka filluar prej vitit 2018 dhe aktualisht, në regjistrim është hedhur cdo dokument që përmbanë dosja personale e psikologut, si dhe të dhënat e tij, të cilat duhet të jenë të hapura për publiku. Prosesi ka qenë

jashtëzakonisht voluminoz dhe në të, përveç administratës së UP, janë përfshirë në vazhdimësi edhe grupe vullnetarësh. Prosesi ka marrë kohë pasi aktualisht në regjistrim ka të hedhur dokumentacion të plotë të 1512 anëtarëve të UP. Janë skanuar me mijra faqe dokumentacion gjatë këtyre viteve. Një proces ky që është përmblyllur me sukses pa kosto shtesë financiare.



Ky regjistër është ndërtuar në formën e një platforme dhe përmban të dhënat identifikuese profesionale për secilin psikolog. Regjistri është ndërtuar të funksionojë në dy sisteme. Në sistemin elektronik përfshihet çdo e dhënë për psikologët anëtarë, ndërkohë që online publikohen dhe janë të dukshme vetëm të dhëna të domosdoshme për publikun, të cilat mund të aksesohen nga vetë psikologët, apo të interesuarit.

Regjistri online i publikuar është i ndarë në këto rubrika: numri identifikues për çdo të anëtarësuar, emri/mbiemri, vendbanimi dhe numri i kontaktit ose në mungesë, adresa e postës elektronike. Vendbanimi është një e dhënë e domosdoshme në mënyrë që të interesuarit të identifikojnë psikologët që ushtrojnë profesionin pranë vendbanimeve të tyre për të marrë shërbim më të shpejtë kur u nevojitet.

Për më tepër, në platformën e re të ndërtuar, mundësohet që të ruhet në mënyrë të

Urdhri i Psikologut, si institucion i përcaktuar me ligj për dhënien e lejes së ushtrimit të profesionit të psikologut, ka nisur që me krijimin e tij, në mars 2017, korrespondencë aktive dhe takimet me ministrinë e linjës dhe institucione të tjera, për dhënien e licencave profesionale për kategorinë e psikologëve, që përjashtojnë nga detyrimi për të dhënë provimin e shteti dhe, njëkohësisht. Takimet dhe korrespondenca ka qenë mjaft intensive gjatë këtyre viteve edhe për realizimin e provimit të parë të shtetit, që do t'i hapte rrugën licencimit të psikologëve të diplomuar pas hyrjes në fuqi të ligjit 40/2016 "Për Urdhrin e Psikologut në Republikën e Shqipërisë". Prononcimet publike dhe mediatike për zvarritjen e procesit nga MASR kanë qenë të vazhdueshme e të intensifikuara gjatë 6 mujorit të dytë të vitit 2020.

dixhitalizuar i gjithë dokumentacioni i paraqitur nga psikologu pranë Urdhrit të Psikologut, si dhe çdo e dhënë që lidhet me jetën e tij profesionale, si dhe me procesin e licencimit dhe të rilicencimit. Në regjistër, në një rubrikë të veçantë, pasqyrohet edhe sasia e krediteve të marra nga çdo psikolog në kuadër të edukimit në vazhdim, dhe ndarja e tyre sipas fushës së mbuluar të aktivitetit. Kjo platformë përmbanë gjithashtu edhe një foto identifikuese të psikologut. Linku i regjistrimit online është i aksesueshëm nga vetë psikologu nëpërmjet kodit QR të kartës së anëtarësisë, i cili lidhet menjëherë me faqen profesionale në web të vetë psikologut. Platforma do të jetë dinamike, pasi të dhënat e psikologëve do të jenë në vazhdim të përditësuara.

5. Rruga drejt provimit të parë të shtetit për profesionin e psikologut

Me insistimin dhe përkushtimin maksimal, Urdhri i Psikologut, në vetëm pak muaj, ka mundësuar shpërndarjen për herë të parë në Republikën e Shqipërisë të Lejeve Individuale të Ushtrimit të Profesionit të Psikologut (Licencave Profesionale), për të gjithë atë kategori psikologësh, të cilët kishin përfunduar të dy ciklet e studimit përpara hyrjes në fuqi të Ligjit 40/2016, si dhe kishin ushtruar profesionin e psikologut në mënyrë të rregullt përpara hyrjes në fuqi të ligjit, për të paktën 1 vit. Aktualisht, në bazë të vendimit të gjykatës, kemi vijuar të shpërndajmë licenca edhe për ata psikologë që kanë përfunduar një cikël studimi në psikologji dhe kanë ushtruar profesionin e psikologut përpara hyrjes në fuqi të ligjit, ndërkohë që kanë përfunduar ciklin e dytë të studimit pas hyrjes në fuqi të ligjit, pra pas majit 2016.



Institucioni ynë vijon të jetë në pritje për nisjen e procesit për hartimin e fondit të pyetjeve për provimin e shtetit nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Kemi dërguar edhe përfaqësuesin e U.P., në grupin që do të angazhohet specifikisht me miratimin e fondit të pyetjeve, por sërish procesi nuk ka nisur ende.

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, me vendimin Nr.331, datë 22.04.2020, miratoi V.K.M-në “Për një shtesë në Vendimin nr.649, datë 14.09.2011, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e listës së specialiteteve, nënspecialiteteve apo specialiteteve plotësuese për profesionet e rregulluara”, lidhur me plotësimin e nënspecialiteteve mbi profesionet e rregulluara të vendimit nr.649, dt.14.09.2011 të Këshillit të Ministrave. Kjo VKM u botua në Fletoren Zyrtare datë 29.04.2020.

Të gjithë përfaqësuesit e grupeve të interesit dhe institucioneve, në përputhje edhe me V.K.M-në Nr. 514, dt. 20.9.2017, “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP) (të rishikuar), kishin dakordësuar fillimisht për caktimin e specialiteteve për Provimin e Shtetit për psikologët, si më poshtë:

- 1) Psikologji - Profili “**Psikologji Klinike dhe të tjera në fushën e Shëndetit Mendor**”
- 2) Psikologji - Profili “**Psikologji Shkollore dhe të tjera në fushën e Edukimit**”
- 3) Psikologji - Profili “**Psikologji e Komunitetit dhe të tjera në fushën Sociale**”
- 4) Psikologji - Profili “**Psikologji Pune dhe Organizacionale**”
- 5) Psikologji - Profili “**Psikologji Ligjore dhe të tjera në fushën Juridike**”.

Ne gjykojmë se miratimi i VKM-së 331 dhe mungesa e përcaktimit të

specialiteteve dhe nënspecialiteteve në hartimin e Provimit të Shtetit për psikologët, do të krijonte një problematikë të madhe sa i përket formimit dhe kualifikimit të psikologëve, ndaj lidhur me këtë shqetësim vumë në dijeni Ministrinë së Sportit dhe Rinisë në një material të zgjeruar ligjorë dhe profesional. Ndonëse nuk morëm asnjë përgjigje zyrtare nga kjo ministri për këtë anashkalim të profileve të dakordësuar, në rrugë jo zyrtare u vumë në dijeni, se profilizimi do të sillte një kosto të lartë financiare në hartimin e pyetjeve nga Qendra e Shërbimeve Arsimore (QSHA) për shkak se cdo profil do të kërkonte një grup pune më vete. Në këtë mënyrë na u transmetua se për të minimizuar kostot financiare nuk u miratua një VKM ku të përcaktoheshin specialitetet.

Ndonëse ishte kjo mangësi e sipërcituar, gjykojmë se miratimi i V.K.M –së “Për një shtesë në Vendimin nr.649, datë 14.09.2011, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e listës së specialiteteve, nënspecialiteteve apo specialiteteve plotësuese për profesionet e rregulluara”, lidhur me plotësimin e nënspecialiteteve mbi profesionet e rregulluara të vendimit nr.649, dt.14.09.2011 të Këshillit të Ministrave, botuar në Fletoren Zyrtare datë 29.04.2020, ishte një hap i rëndësishëm përpara, për nisjen dhe formalizimin e procesit të zhvillimit të Provimit të Parë të Shtetit. Kemi ndihmuar dhe shtyrë që të procedohej sa më shpejt për nisjen e hartimit të fondit të pyetjeve, duke qenë se aktualisht një numër i lartë psikologësh mbeten në pritje të kryerjes së këtij provimi, për të përfutur licencën profesionale. Aktualisht jemi në pritje nga QSHA që të ngrihen grupet e punës për hartimin e programit dhe fondit të pyetjeve për provimin e shtetit të psikologëve.



6. Rrjetet Sociale të Urdhrit të Psikologut

Urdhri i Psikologut krahas faqes zyrtare të website-it www.urdhriipsikologut.al, për të



informuar anëtarët e tij dhe publikun përdor gjithashtu dhe dy nga rrjetet sociale më popullore aktualisht, sic janë Facebook dhe Instagram. Ndërkohë planifikojmë të hapim edhe faqen tonë zyrtare në rrjetin profesional LinkedIn.


Faqja e Urdhrit të Psikologut në rrjetin social Facebook, u hap për here të pare në Prill të vitit 2017.


Përsa i përket statistikave në Facebook, mund të veçojmë faktin se, totali i

ndjekësve në datë 1 janar 2020 ka qenë 6423 ndjekës dhe në fund të vitit ka patur 7799 ndjekës, pra brenda periudhës 12 muajore të vitit 2020, kemi patur një rritje me 1376 ndjekës, siç ilustron edhe në grafikun e mëposhtëm.

Në dy grafikët e mëposhtëm shihet se si varion nga muaji në muaj, shikueshmëria e postimeve që insitucioni ynë publikon, si dhe numri i vizitorëve në faqe.

Rrjeti social Instagram i Urdhrit të Psikologut është krijuar në muajin Mars të 2018. Aktualisht në këtë faqe ka rreth 2000 ndjekës. Numri i ndjekësve në Instagram vijon të ketë një rritje konstante, kjo për shkak të popullaritetit që ky rrjet social ka aktualisht jo vetëm në Shqipëri, por në të gjithë botën. Vizitat në profil qëndrojnë mbi 1023 në një periudhe kohore prej një muaji. Klikimet në website nga rrjetet sociale janë +25% sipas statistikave të fundit dhe butoni më i përdorur është butoni telefonatës, i cili vazhdon të rritje 266% dhe krahasuar me një muaj përpara.





Rritja e vazhdueshme çdo muaj e ndjekësve dhe e shikueshmërisë së postimeve tona në këto dy rrjete sociale, është tregues i faktit që, me anë të postimeve që Urdhri i Psikologut vazhdimisht kryen, krahas faqes zyrtare të website-it, por edhe në rrjetet sociale (Facebook dhe Instagram), anëtarët e tij mund të kenë

aksesin e nevojshëm për t'u informuar lidhur me të rejat më të fundit dhe se çfarë u duhet të dinë apo të mbajnë në konsideratë gjatë ecures në punën e tyre.

7. Buxheti

7.1 Të ardhurat

Projekt-Buxheti i vitit 2020 parashikonte mbledhjen e të ardhurave në masën 9,250,000.00 lekë të reja. Ndërkohë në vitin 2020 Urdhri ka tejkaluar mbledhjen e të ardhurave nga aktiviteti i kryer në masën 10,721,105.00 lekë.

Të ardhurat nga tarifa e licencimit për vitin 2020 janë për rreth 88 psikologë të rinj, duke mbajtur në konsideratë se realizimi i provimit të parë të shtetit nuk arriti të përmbylej këtë vit buxhetor.

Në mbledhjen e të ardhurave janë mbajtur në konsideratë edhe tarifat që vijnë nga implementimi i sistemit të edukimit në vazhdim rreth 651,800.00 lekë, nisur nga fakti se ky proces është në vitin e dytë të funksionimit dhe interesi për pjesëmarrjen e subjekteve trajnuese në këtë proces ka qënë i lartë. Edhe në këtë zë kemi rritje, por duhet mbajtur në konsideratë se shpenzimet për të mbajtur strukturën e Edukimit në Vazhdim (komisioni, ekspertët, shpenzime operative) janë të



larta dhe thuajse e gjithë vlera që arkëtohet nga edukimi në vazhdim, shpenzohet.

Në tërësi, gjatë vitit 2020 zëri i të ardhurave të ligjshme të Urdhrit të Psikologut është rritur në masën 41.4% më

shumë duke e krahasuar me vitin fiskal 2019.

Më poshtë gjeni të pasqyruar tabelën përmbledhëse të të ardhurave për vitin 2020.

Tabela përmbledhëse e të ardhurave për vitin 2020

Emërtimi	Vlera	Monedha
<i>Të ardhurat:</i>		
<i>Kuotizacionet e anëtarëve</i>	6,929,025	ALL
<i>Tarifa për regjistrim</i>	1,220,465	ALL
<i>Tarifa për licensim</i>	1,320,005	ALL
<i>Të ardhura nga edukimi në vazhdim</i>	651,800	ALL
<i>Të ardhura nga lëshimi i vërtetimeve të anëtarësisë</i>	48,400	ALL
<i>Të ardhura nga trajnimet e organizuara</i>	228,000	ALL
<i>Të ardhura nga botimi i Kodit të Etikës</i>	14,400	ALL
<i>Të ardhura nga komisioni i vlerësimit të aftësive</i>	309,010	ALL
Totali	10,721,105	ALL

7.2 Shpenzimet

Duke marrë parasysh që ky është viti i katërt i funksionimit të Urdhrit të Psikologut, eksperiencë e këtyre viteve ka ndihmuar për të menaxhuar të ardhurat, në mënyrë që të shmangen situatat kritike ekonomike, duke ruajtur një balancë të arsyeshme për shpenzimet e detyrueshme, për t'u realizuar sipas planifikimit.

Sipas projekt-buxhetit të vitit 2020, ishte parashikuar realizimi i shpenzimeve të miratuara sipas zërave si më poshtë:

Paga – 3,632,174 lekë

Shpenzime operative – 5,804,081 lekë

Shpenzime kapitale – 142.371 lekë

Shpenzimet për pagat kanë një rritje të vogël me 0.9% nga viti paraardhës, pasi për shkak të mbingarkesës së stafit të vogël, u propozua që të shtojmë me kohë pune part-time një punonjës IT, paga mujore e të cilit u vendos në në masën 26.000 lekë bruto.

Në total në zërin e shpenzimeve operative janë shpenzuar 5,804,081 lekë. Kjo ka ardhur së pari për shkakun se të ardhurat janë mbledhur mbi masën e parashikuar,



çfarë ka mundësuar kryerjen e shpenzimeve të nevojshme të paparashikuara, por që kanë mudnësuar aktivitetin normal të

UP dhe na kanë ndihmuar në arritjen e objektivave.

Tabela përmbledhse e shpenzimeve operative për vitin 2020

Emërtimi	Vlera	Monedha
<i>Shpenzime për sigurimet shoqërore & shëndetsore</i>	595,770.00	ALL
<i>Shpenzime për honorare</i>	1,672,702.00	ALL
<i>Shpenzime për qira zyre</i>	837,485.00	ALL
<i>Shpenzime administrative të funksionimit</i>	1,397,604.00	ALL
<i>Shpenzime për aktivitete & marrëdhënie ndërkombëtare</i>	681,143.00	ALL
<i>Shpenzime për printime, publikime dhe manaxhim në web</i>	519,109.00	ALL
<i>Shpenzime për veprimet bankare e të tjera</i>	100,218.00	ALL

Gjatë vitit 2020 janë bërë shpenzime kapitale në masën 142,371.00 lekë, pavarësisht parashikimit të tyre, me qëllim ruajtjen e stabilitetit financiar. Këto shpenzime u kryen me qëllim skedimin e doku-

mentacionit për anëtarësinë dhe shtim të rafteve fizike në zyrë, për ruajtjen e tyre.

Më poshtë paraqitet e detajuar në zëra një tabelë përmbledhëse e shpenzimeve të kryera gjatë këtij viti.

Tabela përmbledhse e shpenzimeve për vitin 2020

Emërtimi	Vlera	Monedha
<i>Shpenzimet:</i>		
<i>Paga</i>	3,632,174.00	ALL
<i>Shpenzime Operative</i>	5,804,031.00	ALL
<i>Shpenzime Kapitale</i>	142,371.00	ALL
Total	9,578,576.00	ALL



Këto shpenzime të kryera janë në vlerat e funksionimit normal të institucionit gjatë një viti pandemik ku shumë aktivitete nuk janë kryer dhe janë anuluar, përfshi këtu aktivitetin kombëtar dhe ndërkombëtar të institucionit.

Siç shihet, buxheti faktik i vitit 2020 ka ruajtur një balancë të qëndrueshme midis të ardhurave dhe shpenzimeve, duke vijuar ruajtjen e stabilitetit ekonomik të institu-

cionit, duke mbajtur në konsideratë gjëndjen e shkaktuar prej Covid-19 si dhe reflekton ambicien për të kaluar në një fazë të re të funksionimit të Urdhrit, me qëllim që aktiviteti i tij të bëhet sa më i ndjeshëm në politikat kombëtare dhe ndërkombëtare, të jetë sa më i prekshëm për anëtarësinë dhe, mbi të gjitha, të përm-bushë misionin ligjor për të cilin është kri-juar në bazë të ligjit 40/2016 për “Urdhriin e Psikologut në Republikën e Shqipërisë”.

8. Objektivat e realizuar gjatë vitit 2020

- ✓ Rritja e numrit të psikologëve të regjistruar si anëtarë të Urdhrit.
- ✓ Fuqizimi i rolit të psikologut në shoqëri nëpërmjet aktiviteteve të trupës së psikologëve në ndihmë të popullatës.
- ✓ Rritja e bashkëpunimit dhe formalizimi i marrëveshjeve dypalëshe me Shoqatën Amerikane të Psikologjisë (American Psychological Association – APA), në kuadër të shkëmbimit të eksperiencës dhe ndihmës reciproke, për fuqizimin e rolit të psikologut në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.
- ✓ Rritja e numri të psikologëve shkollorë në arsimin parauniversitar me 204 punonjës të rinj.
- ✓ Ruajtja e bashkëpunimit të ngushtë me pushtetin qendror dhe lokal, jo vetëm në fuqizimin e rolit të psikologut, por edhe në projekte të përbashkëta në nivel lokal dhe kombëtar, të cilat kanë faktorizuar punën e psikologut në terren.
- ✓ Shtimi i aktiviteteve të edukimit në vazhdim, që mundëson marrjen e krediteve nga psikologët, të nevojshme në procesin e rilicencimit.
- ✓ Ndjekja e të gjithë procedurave dhe nxitja e organeve më të larta shtetërore për realizimin sa më parë të provimit të shtetit.
- ✓ Riformatimi i Komisionit të Etikës dhe Gjykimit Disiplinor për të garantuar njëtrajtshmëri, profesionalitet dhe efikasitet në vendim-marrje
- ✓ Realizimi i provimit të Vlerësimit të Aftësisë Praktik, si parakusht i pjesëmarrjes në provimin e shtetit
- ✓ Rritja e standardeve të psikologëve pranë strukturës së Policisë së Shtetit, nëpërmjet realizimit të trajnimeve dhe standardizimit të dokumentacionit.
- ✓ Ruajtja e qëndrueshmërisë së institucionit dhe mbarëvajtja e aktivitetit.



9. Objektivat për vitin 2021

- ❖ Vazhdimi i procesit të formalizimit të ushtrimit të profesionit, nëpërmjet rritjes së numrit të psikologëve të regjistruar si anëtarë të Urdhrit.
- ❖ -Përgatitja për mundësinë e lëshimit të certifikatës EuroPsy, e njohur në të gjithë vendet anëtare të EFPA-s.
- ❖ -Krijimi i divizioneve brenda Urdhrit të Psikologut, si struktura që bashkojnë psikologët e të njëjtës fushë kompetente, si faktorë dinamikë për zhvillimin praktik të secilës fushë të psikologjisë në vend.
- ❖ -Rregullimin e plotë në aspektin profesional të procesit të supervizimit, duke krijuar një rrjet supervizorësh të trajnuar, për të rritur cilësinë efektive të procesit të Praktikës Profesionale, sipas standardeve të EFPA-s.
- ❖ -Rritja e rolit të Urdhrit të Psikologut në marrëdhëniet ndërkombëtare, nëpërmjet pjesëmarrjes intensive në grupet e punës të EFPA-s.
- ❖ Rritja e bashkëpunimit me Shoqatën Europiane të Psikologëve të Punës dhe Organizacionalë (EAWOP), duke synuar përfaqësimin e Shqipërisë në komisionit e përhershme dhe grupet e punës të kësaj organizate dhe duke lobuar për fuqizimin e rolit të psikologut organizacional në Shqipëri.
- ❖ Marrja e statusit të vendit anëtar me të drejta të plota në Unionin Ndërkombëtar të Shkencës së Psikologjisë (International Union of Psychological Science - IUPsyS), si një nga organizatat më të rëndësishme botërore në fushën e psikologjisë.
- ❖ Realizimi në vazhdimësi i provimeve të Vlerësimit të Aftësisë Praktik, si parakusht i pjesëmarrjes në provimin e shtetit.
- ❖ Vijimi i ndjekjes së procedurave për realizimin e provimit të parë të shtetit për profesionin e psikologut dhe realizimi i provimit të Parë të Shtetit.
- ❖ Fuqizimi i rolit dhe statusit të psikologut në institucione, nëpërmjet miratimit të protokolleve të punës për secilën fushë të kompetencës.
- ❖ Vazhdimi i zgjerimit të rrjetit të koordinatorëve lokalë.
- ❖ Standardizimi i punës së psikologut të edukimit, nëpërmjet përgatitjes së manualeve dhe protokolleve praktike, të cilave duhet t'i referohen.
- ❖ Standardizimi i punës së psikologut në polici.
- ❖ Përmirësimi i sistemit të Edukimit në Vazhdim në psikologji, me qëllim rritjen e efektivitetit të tij.

